*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F499RED2, F519 dhe F579*

E hënë, 1 maj 2023

[Seancë e hapur]

[I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

--- Seanca fillon në orën 09.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Punonjësja e Gjykatës, ju lutem thërrisni çështjen.

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar. Çështja KSC-BC-2020-04, Prokurori i Specializuar kundër Pjetër Shalës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së pari, ju lutem palëve të prezantohen.

Keni fjalën, Prokurori i Specializuar.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Mirëmëngjes. Faleminderit. Për Zyrën e Prokurorisë kemi Alex Whiting, ushtrues i detyrës së Prokurorit të Përgjithshëm. Kemi Giulia Bianchi, punonjëse eksperte, Line Pedersen dhe Gaia Pergolo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mbrojtësi i Viktimave.

Z. LAWS: [Përkthim] Mirëmëngjes. Unë jam Simon Laws, Mbrojtësi i Viktimave bashkë me ndihmësen time Maria Radziejowska.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Mbrojtësi i Viktimave [sipas përkthimit], keni fjalën.

Z. GILISSEN: [Përkthim] Faleminderit, znj. Kryetare. Jemi

këtu me z. Pjetër Shala që do ta ndjekë përmes videolink. Unë jam Jean-Louis Gilissen, Mbrojtësi i Specializuar. Jemi këtu bashkë me z. Hedi Aouini, Leto Cariolou. Ata besoj do të punojnë me dëshmitarin. Kemi znj. Dzeneta Petravica, përgjegjëse e çështjes, Xhulia Tepshi dhe Methias Lenglet, janë dy stazhierë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Do të vazhdojmë sot me paraqitjen e provave nga Prokurori i Specializuar. Do të dëgjojmë konkretisht Dëshmitarin numër 10. Do të punojmë me tre seanca nga një orë e gjysëm dhe pastaj do të bëjmë pushimet e zakonshme dhe pushimin e drekës një orë e gjysëm.

Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit, Trupi Gjykues do të lëshojë një urdhër me gojë.

Z. Shala, sa për të konfirmuar, na dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Trupi Gjykues do të lëshojë një urdhër gojor.

ZPS-ja ka kërkuar që atë lejohet që gjatë pyetjeve që do t'i bëjë Dëshmitarit 10 të përdoren të regjistrimit me audio dhe video të intervistës së dëshmitarit. Fragmentet në audio dhe në video i korrespondojnë transkriptit të nxjerrë më parë me numër ERN 083537-TR-ET Pjesa 2 RED dhe 108836-TR-ET Pjesa 1

RED, që janë paketat e nxjerrjes së materialit 11 dhe 103 përkatësisht. Kjo kërkesë e ZPS-së u bë me email më 24 prill 2023, në orën 11.02 minuta. Të dy fragmentet me video u zbuluan më 24 prill 2023, në orën 09.52 minuta. Pra, ishte paketa me materiale 117 dhe ju shtuan radhës së prezantimit të dëshmive për këtë dëshmitar.

Mbrojtja dhe Mbrojtësi i Viktimave nuk kanë paraqitur ndonjë kundërshtim.

Trupi Gjykues do ta autorizojë ZPS-në t'i përdorë këto dy fragmente me video. Incizimet me video nuk përfaqësojnë ndonjë material apo përmbajtje të re për të cilën Mbrojtja nuk ka pasur dijeni sepse janë nxjerrë më përpara. Dhe fragmentet vetë janë zbuluar më përpara seancës së sotme me arsyetim të mjaftueshëm dhe asnjë, as Mbrojtja, as Mbrojtësi i Viktimave nuk kanë paraqitur kundërshtim. Në fakt, Trupi Gjykues vëren se Mbrojtja gjithashtu synon t'i përdorë këto fragmente gjatë pyetjeve të veta. Dhe në rrethanat e tanishme Trupi Gjykues mendon se kjo do të lehtësojë dëshminë.

Dhe këtu përfundon urdhri i Trupit Gjykues.

Do të vazhdojmë me dëshminë e dëshmitarit. Do ta dëgjojmë dëshminë me anë të videokonferencës.

Punonjësi i Gjykatës, ju lutem ftojeni dëshmitarin të vijë në sallën e gjyqit, të paraqitet përmes videolinkut.

[Dëshmitari paraqitet përmes videolidhjes]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim]

Konfirmoj që dëshmitari është këtu i pranishëm bashkë me mua, pra, punonjëse e lartë e Gjykatës dhe punonjësi i Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni, ju lutem.

Z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Urdhnoni.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirëmëngjes, z. Dëshmitar.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirëmëngjes, znj. Gjyqtare.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se keni ardhur në Dhomat e Specializuara. A më dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, mirë dëgjoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Shala, a e dëgjoni dëshmitarin?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, shumë mirë e ndëgjoj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Si jeni sot, z. Dëshmitar?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Mirë jam.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

Sot do të fillojmë me dëshminë tuaj, por përpara se ta

bëjmë këtë, kam disa gjëra për t’ju thënë.

Punonjësja e Gjykatës, a mund ju lutemi të futemi në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike,

të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Z. Dëshmitar, tani do t'ju shpjegoj shkurtimisht masat mbrojtëse që janë miratuar për ju gjatë dëshmisë suaj.

Ju është dhënë një pseudonim dhe kjo do të thotë që nuk do ta përdorim asnjëherë emrin tuaj dhe do t'ju drejtohemi vetëm me fjalët "Z. Dëshmitar", me qëllim që publiku të mos e mësojë emrin tuaj.

Gjithashtu do t'jua shtrembërojmë dhe fytyrën edhe zërin, që do të thotë se askush jashtë kësaj salle gjyqi që do të ndjekë transmetimin e seancës nuk do ta dëgjojë fytyrën [sipas përkthimit] dhe nuk do t'ju dëgjojë zërin tuaj të vërtetë gjatë dëshmisë.

Kur t'i përgjigjeni pyetjeve që nuk do të nxjerrin identitetin tuaj, këtë do ta bëjmë në seancë të hapur, që do të thotë publiku do të dëgjojë atë që thuhet në sallën e gjyqit.

Kur t'ju bëjnë pyetje, kur t'ju kërkojnë të përshkruani gjëra që kanë të bëjnë konkretisht me ju apo të përmendni fakte që mund të nxjerrin në pah identitetin tuaj, këtë do ta bëjmë në seancë private. Dhe kjo do të thotë që nuk do të transmetohet për publikun dhe askush jashtë kësaj salle nuk do të dëgjojë atë që do të thuhet këtu.

Nëse thuhet diçka gjatë seancës së hapur që mund t'ju

identifikojë, do ta mbrojmë këtë informacion. Dëshmia juaj do të transmetohet me pak vonesë dhe gjatë kësaj vonese mund të heqim çdo informacion që nuk duhet të transmetohet që të mos dëgjohet dhe të mos shihet nga publiku, gjithashtu do ta heqim edhe nga transkripti për publikun, pra, transkripti i seancës.

Këta masa mbrojtëse që ju shpjegova janë të qarta për ju, z. Dëshmitar?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, janë të qarta.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar.

Të gjithë të pranishmit në sallën e gjyqit duhet të respektojnë masat mbrojtëse dhe t'i kushtojnë vëmendjen më të madhe gjatë pyetjeve të tyre, duke shmangur zbulimin e çdo informacioni konfidencial gjatë seancës.

Z. Dëshmitar, tani po ju kthehem përsëri juve.

Jeni thirrur këtu të dëshmoni përpara Dhomave të Specializuara në çështjen Prokurori i Përgjithshëm kundër z. Pjetër Shala për ta ndihmuar Trupin Gjykues të dali me një vendim.

Pasi të keni bërë betimin solemn për të thënë të vërtetën, mbrojtësit e Zyrës së Prokurorisë do t'ju bëjnë pyetje. Janë njerëzit të veshur me këtë mantelin me ngjyrë të kuqe [sipas përkthimit]. Pastaj do t'ju bëjë pyetje Mbrojtësi i Viktimave dhe Mbrojtësi i z. Shala apo ekipi mbrojtës i veshur me të kuqe dhe ne, që jemi këtu përpara që jemi

Gjykatësit e këtij Trupi Gjykues.

Dhe dua t'ju jap disa udhëzime, z. Dëshmitar, që t'u përgjigjeni pyetjeve që do t'ju bëjnë.

Më dëgjoni me kujdes, dëgjojeni me kujdes çdo pyetje dhe nëse nuk e kuptoni pyetjen, mos nguroni, kërkoni t'jua përsërisim. Duam që të thoni të vërtetën, të na thoni çfarë keni parë, çfarë keni dëgjuar, ç'keni jetuar vetë. Nëse nuk e keni parë, nuk e keni dëgjuar vetë, ju lutem na e thoni dhe na shpjegoni se nga e keni mësuar. Mbase nuk ju kujtohen të gjitha hollësitë e këtyre ngjarjeve dhe kjo është në rregull. Ju lutem dëshmoni për atë që mbani mend. Mos hamendësoni, mos i sajoni nga mëndja. Nuk ka asgjë të keqe të thoni "Nuk e di".

Ka dhe dy gjëra të tjera që dua t'ju them.

Punonjës i Gjykatës, ju lutem të kalojmë në seancë private?

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani do t'ju jap disa këshilla praktike.

Gjithçka që themi këtu përkthehet dhe incizohet dhe ka rëndësi, është me rëndësi që të flisni afër mikrofonit, të flisni qartë dhe të flisni me ngadalë, sepse kjo do t'u japë mundësi përkthyesve të përkthejnë gjithçka që thuhet.

Filloni të përgjigjeni vetëm pasi ka mbaruar personi që ju bën pyetjen. Kur ju bëhet një pyetje, ju lutem prisni pesë sekonda dhe pastaj jepni përgjigjen, sepse ky pushimi pesë sekonda është shumë i rëndësishëm na lejon të ndjekim me kujdes gjithçka që thoni.

Në qoftë se unë do të ngre dorën, siç e ngrita tani pushoni së foluri, mos flisni më.

Ndonjëherë mund të na ndërpritet videoja dhe audioja në qoftë se diçka ka nevojë të diskutohet lidhur me përmbajtjen e përgjigjeve tuaja.

Nëse keni ndonjë pyetje, nëse keni nevojë për ndonjë pushim apo nëse keni nevojë për ndonjë ndihmë, në çdo moment, ju lutem ngrini dorën me qëllim që unë ta di që keni dëshirë

të thoni diçka.

I kuptuat të gjitha këto që ju thashë, Dëshmitar?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Shumë mirë.

Mbrojtës, këto që thashë vlejnë edhe për ju. Nëse doni të komunikoni me Trupin Gjykues, ngrini dorën dhe unë do t'ju jap fjalën.

Z. GILLIS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani do t'ju kërkoj që të bëni deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Dhe dua t'ju kujtoj se është vepër penale si mbas juridiksionit të kësaj Dhome Gjykuese të jepni dëshmi të rreme.

E kuptoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, ju lutem përsërisni mbas meje.

I vetëdijshëm për rëndësinë e dëshmisë sime...

Z. Dëshmitar, unë do të lexoj një pjesë të deklaratës solemne dhe juve duhet ta përsërisni mbas meje. Pra, unë filloj:

I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime.

Përsëriteni mbas meje.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] I ndërgjegjshëm për

dëshmien time.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe për përgjegjësinë time ligjore.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Dhe për përgjegjësinë time ligjore.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Deklaroj solemnisht.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Deklaroj solemnisht.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Se do të them të vërtetën.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Do të them të vërtetën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të gjithë të vërtetën dhe asgjë përveç të vërtetës.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Të gjithë të vërtetën dhe asgjë përveç të vërtetës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe se nuk do të lë gjë pa thënë.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Se nuk do të lë gjë pa thënë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që di.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Që di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Dëshmitar. Tani jeni nën betim për të thënë të vërtetën.

DËSHMITARI: TW4-10

[Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani mund të fillojmë me pyetjet tuaja. Do të fillojmë me pyetjet që do të bëjë Zyra e Prokurorit të Specializuar.

Znj. Prokurore, vura re se keni parashikuar tre orë për t'i bërë pyetje dëshmitarit. Nëse do të ketë ndonjë ndryshim më njoftoni.

Tani keni fjalën.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

Pyetje nga Znj. Wyler: [Përkthim]

PY. Mirëmëngjes, Dëshmitar.
PË. Mirëmëngjes.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Sikundër e shpjeguan Gjykatësit, gjykatësit [sipas përkthimit] i janë miratuar masa mbrojtëse. Do të filloj t'ju bëj disa pyetje lidhur me familjen, atë vetë dhe do të kërkoj që të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Prokurore, vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, keni qenë ndonjëherë anëtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?

PË. Po.

PY. Kur jeni kyç në UÇK?

PË. Në UÇK unë në 1998 jam kyç në Kukës.

PY. A e mbani mend në ç'muaj ka qenë kur jeni kyç në UÇK?

PË. A ka tash ka qenë ja marsi a prill.

PY. A mund të na shpjegoni sesi ndodhi që u kyçët në UÇK në Kukës?

PË. Po. Kemi pasë lidhje. Po edhe i pritshin. Edhe lidhje kam pasë unë pak ma herët nja dy muaj ka *[REDAKTUAR]*, po i pritshin në Granicë, në Kukës.

PY. Çfarë do të thoni me fjalët "i prishim në Kukës" çfarë keni parasysh me këto?

PË. Me këto që në Granicë të Shqipnies i pritshin ushtarët Ushtria Çlirimtare dhe i mobilizojshin. Unë kam qenë si i njoh aty ma herët pak prej *[REDAKTUAR]*, kam qenë si njofshëm. Këta që dilshin demek 25 vjeç, 30 vjeç, i mirrshin për çdo familje ka një që i ka dy vëllazën, që i ka tre vëllazën, një vike edhe me vullnet vike, u kyçshin në Ushtrinë Çlirimtare.

PY. Pasi u kyçët në UÇK në mars apo prill 1998, u kthyet në vendin ku banonit më parë apo qëndruat aty?

PË. Jo, jo. Jo, aty. Unë kam qëndru në Kukës.

PY. Ju lutem, a mund të na shpjegoni procesin e rekrutimit që kaluat dhe ju vetë?
PË. Nuk po e kuptoj, znj. Prokurore, ça po doni me këtë fjalë?
PË. Ju thatë që u kyçët në UÇK në Kukës. A mund të na e shpjegosh si u kyçët, sesi mund të kyçeshe në UÇK në atë kohë, a mund të na e shpjegosh?
PË. Po. Si kam dalë Granicën, në Granicë të Shqipnies, kanë qenë ushtarët me uniforma edhe aty jam kyçë menjëherë dhe kam shku për Kukës.
PY. Përse keni shku në Granicë atëherë?
PË. Po patjetër na kanë -- patjetër u dusht me ik prej këtujit se koha e lufte.
PY. Dhe a të kujtohet mirë që ka qenë mars apo prill i 1998, apo mos vallë ka qenë 1999?
PË. Jo, jo, 1998.
PY. Thatë që menjëherë pasi u kyçët në Granicë, u larguat menjëherë në drejtim të Kukësit. Si shkuat në Kukës?
PË. Po me dy ushtarë kam shku.
PY. Ku të çuan ata?
PË. Më çun në shtab në Kukës, në shtab të logjistikës.
PY. Sa i takon kohës, a të kujtohet në qoftë se kjo ka ndodhur përpara apo pas bombardimeve të NATO-s?
PË. Edhe njëherë s’e kuptova pyetjen, znj. Prokurore?
PY. Kur ka ndodhur kjo në kohë, a të kujtohet në qoftë se ka

ndodhur përpara bombardimeve të NATO-s apo pas bombardimeve të NATO-s?
PË. NATO-ja ka qenë tuj bombardu.
PY. Në atë kohën kur u kyçët ju në UÇK, e kuptova drejt, që në atë kohë ndërkohë NATO-ja vazhdonte me bombardimet, kështu?
PË. Ashtu është.
PY. Na thatë - dhe i referohem këtu transkriptit të përkohshëm në faqen 15, rreshtat 7 dhe 8 – thatë që dy ushtarët të dërguan në shtabin e logjistikës ose në shtabin e Kukësit. A kishte një emër ky vend?
PË. Veç shtab sa e di unë. Sa e di unë veç shtabi i logjistikës.
PY. Në çfarë njësie të UÇK-së u kyçe ti?
PË. Ushtar. Si ushtar i thjeshtë.
PY. A ishit pjesëtar i një njësiti të veçantë të UÇK-së, i një brigade për shembull?
PË. S’e kuptova pyetjen, znj. Prokurore.
PY. Si ushtar, a bënit pjesë në një njësi të veçantë të UÇK-së, a bënit pjesë në një brigadë, për shembull, të caktuar të UÇK-së?
PË. Jo, jo.
PY. Çfarë roli kishe ti në shtabin e logjistikës në Kukës pasi u kyçët në UÇK?
PË. Ushtar i thjeshtë.
PY. Dhe çfarë bëje si ushtar i thjeshtë, çfarë detyrash

kishe? Si ishte e organizuar dita jote?

PË. Roje. Roje. Roje kam bë unë.

PY. Çfarë detyrash kishte roja në shtabin e logjistikës në Kukës, çfarë bënte një roje në shtabin e logjistikës në Kukës?

PË. Po te kapia rujshim. Me ndërrime e kemi pasë, znj. Prokurore.

PY. A kontrollonit ndonjë gjë konkrete ju si roje?

PË. Po.

PY. Çfarë kontrollonit si roje?

PË. Po kamionët vijshin dhe njerëzit vijshin edhe u duhte me i verifiku, me i lyp letërnjoftimet.

PY. A vishnit uniformë? Ishit i veshur me uniformë kur ishit roje?

PË. Po.

PY. Thatë që ishit roje në shtabin e logjistikës në Kukës me turne. A na thua dot ju lutem sesi ishte organizuar roja, si bëhej roja?

PË. Po, sikur të gjitha rojet, ushtarët që janë në mënyrë të rregullt.

PY. A mund të na e sqarosh pak më tepër, ju lutem?

PË. Si të gjitha rojet, si e ka ushtria ligjet, qashtu kam bë roje unë si mbas ligjit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, të lutem a mund të jesh pak më shumë konkret sepse na duhet që ta dëgjojmë nga goja juaj. Nuk mund të mendojmë që

të gjithë e dinë sesi janë të organizuar ushtritë normale. Domethënë, të lutem nëse është e mundur mundohu që të jesh më konkret dhe më shpjegues në përgjigjet tuaja.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Demek kështu është prej 7.00 ndejti në 12.00, jo se ka bë vaki nej 2.00 unë kam bo roje, tek kapia aty. Ka ardhë tani tjetri ushtar më ka zëvendësu mu. Ka ardhë tjetri ka zëvendësu atë. Kështu që natën e ditën ka pasë roje aty te kapia.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. A mund të na thoni se kush e merrte vendimet për turnet? Kush vendoste se cilët ushtarë ishin në një turn të caktuar, kush e merrte këtë vendim?

PË. Sali Saramati.

PY. A qëndronit në një vend të caktuar ju kur ishit si roje tek kjo njësia logjistike, kishit ndonjë vend të caktuar ku kryenit rolin e rojës?

PË. Po. Dhoma ka qenë -- shumë ushtarë kemi qenë. Dhoma ka qenë me 30 kreveta.

PY. Në këtë vendin ju qëndronit apo ishit roje, ku ishin këto 30 vetët e tjerë, qëndronit apo bënit roje aty?

PË. Jo, jo. Aty ka qenë dhoma, dhoma që e zëvendësojshim njani-tjetrin. Dhoma që flijshim e kemi pasë me 30 veta dhomën.

PY. Po vendin e rojës ku e kishit ju?

PË. Te kapia me një bajrak.

PY. Faleminderit. Ju lutem a mund të na e shpjegoni me disa fjali se çfarë pamje kishte kjo selia e logjistikës ose shtabi logjistik në Kukës?

PË. Kjo veç mobilizimin e ka bë të Ushtrisë Çlirimtare.

PY. A na shpjegon dot se çfarë pamje kishin ambientet, për shembull, a kishte godina, si dukej ai ambienti atje?

PË. Po. Edhe njëherë pyetjen, znj. Prokurore?

PY. A mund të na thoni se çfarë pamje kishte shtabi i logjistikës në Kukës, a kishte godina të tjera, a kishte ndërtesa të tjera, si ishte organizuar shtabi i Kukësit?

PË. Po. Kanë qenë tri...

PY. Tre çfarë?

PË. Ndërtesa.

PY. Në intervistën me ZPS-në në vitin 2019, ju keni vizatuar një skicë, dua që t'jua tregoj këtë skicën.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, dëshiroj që të transmetohet në ekran një provë materiale me numër identifikime ERN 083536 deri në 0835363.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, z. Sekretar, vazhdoni me transmetimin e provës.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ky material nuk duhet të transmetohet për publikun.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Do t'i bëj një pyetje lidhur me përkthimin.

Z. Dëshmitar, a e kupton përkthimin mirë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ta bëj këtë pyetje sepse ndonjëherë thua, domethënë, në përgjigje të pyetjes që ju bëhet, ti jep një përgjigje që është e ndryshme nga pyetja që të bëhet. Kështu që ju lutem mundohuni që t'i jepni përgjigje pyetjes që ju bëhet.

Për shembull, në qoftë se ju kërkohet që të bëni një përshkrim të një vendi të caktuar, nuk e kuptoj që pse ti nuk bën përshkrimin po thua diçka që ka të bëjë me detyrat e ushtarit. Kështu që ju lutem dëgjoni me kujdes pyetjen dhe jepini përgjigje pyetjes.

Z. Dëshmitar, më kuptoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë. znj. Prokurore, vazhdoni ju lutem.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, a shikoni një skicë në ekranin tuaj?

PË. Po.

PY. A është kjo skica që ke vizatuar në intervistën që pate me ZPS-në në vitin 2019?

PË. Po.

PY. Dhe a është nënshkrimi juaj në fund të dokumentit?

PË. Po.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, e kuptojmë

nga Njësia e Menaxhimit të Gjykatës që dëshmitari në qoftë se duhet të shtojë diçka duhet që t'i jepet një dokument i cili është i printuar. Kështu që duhet që ta pyes dëshmitarin në qoftë se i është dhënë një kopje e printuar e kësaj prove materiale që ka numrin 083536 RED dhe dëshmitarit duhet t'i jepet mundësia që të vizatojë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare. E shoh, domethënë, Sekretaren që po i jep dëshmitarit një kopje të dokumentit. E shikojmë këtë dokument edhe në ekran dhe kjo, një kopje e këtij dokumenti sapo ju dha dëshmitarit.

Znj. Prokurore, ju lutem vazhdoni më tej.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Dëshmitar, dëshirojmë që ta kalojmë ose ta përshkruajmë këtë skicë hap pas hapi.

Ju lutem na thoni cila është hyrja për në shtabin e logjistikës?

PË. Hyrja që kjo e para, qetu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A ka një stilolaps dëshmitari në mënyrë të tillë që të mund të na e tregojë ose të vendosë një shenjë?

Znj. Prokurore, çfarë propozoni?

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, një çast, ju lutem. Ju lutem, a mund të vendosni numrin 5 aty ku thatë që ishte hyrja për në shtab?

Z. AOUINI: [Përkthim] Ju lutem, a mund të vendosim germa në vend që vendosim shifër?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si dëshironi, znj. Prokurore, doni që të vazhdojmë me shifra të tjera 5, 6, 7, 8?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull. Atëherë do vazhdojmë kështu.

Për procesverbal, dëshmitari ka shënuar numrin 5 tek skica që ka përpara.

Në të njëjtin vend ku është shifra 1, domethënë, në të njëjtin vend tani kemi edhe 1 edhe 5.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] E kuptoj që ka disa versione të printuara të kësaj skice. Ndoshta do të ishte mirë që të jepni një tjetër skicë që nuk është shënuar, në mënyrë të tillë që të mund të bëjë dhe njëherë shënimin dëshmitari.

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, po i jap një tjetër kopje dëshmitarit dhe po e shkatërroj, po e marr kopjen tjetër e cila do të jetë e pavlefshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull, znj. Sekretare.

Znj. Prokurore, vazhdoni me pyetjet.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, thatë që hyrja është ky vendi ku keni bërë një gjysëm rrethi dhe janë dy vizat e tjera. Ju lutem, a mund ta

shënoni dhe njëherë këtë me shifrën 5?
PË. [Shënon]
PY. Faleminderit. Çfarë ju kujtohet për hyrjen?
PË. Kjo a hyrja. Numër 4 është qëtu ku kemi flejtë. Dhe ata komandantët e mëdhej e kanë pasë zyrën. Numri 3 është qështu si kuzhinë a kanë dhe vijshin ka herë këta të mëdhejt.
PY. Dëshmitar, të kërkoj ndjesë, do të ndërpres. Do t'i kalojmë këto godinat e tjera pak më vonë. Tani po të bëj pyetje thjesht për hyrjen, ju lutem a mund të na thoni se çfarë pamje kishte hyrja, si dukej hyrja?
PË. Po këtu a hyrja, oborri. Asgjë tjetër s'ka qenë këtu si puntori ka qenë. Knejna kanë qenë magazinat.
PY. Z. Dëshmitar, nuk ju përgjigjët pyetjes që u bëra. Do ta bëj edhe një herë pyetjen. Çfarë pamje kishte hyrja? A na përshkruan, për shembull, a kishte një portë që hapej porta për të vijuar më tej? Çfarë pamje kishte hyrja, si dukej hyrja?
PË. Po hyrja portën e ka qetu de. Qetu e ka portën. Qetu e ka. Qetu ka unë rojet, qetu kam bë roje unë. Dhe oborri a këtu.
PY. Në rregull.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Tani kërkoj që të transmetohet prova materiale me numër identifikimi ERN 065594 deri në 065596. Edhe ky dokument nuk duhet të transmetohet për publikun.

Dëshmitarit duhet që t'i tregohet pjesa e sipërme e faqes 065596 në ekran.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Sekretar, ju lutem vazhdoni. Pra, do vazhdojmë me ngarkimin e dokumentit që është shënuar nga dëshmitari në sistemin e Gjykatës, në sistemin Legal Workflow dhe sapo të jetë e mundur do t'i japim një numër prove materiale këtij dokumenti.

Ju lutem, z. Sekretar, vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Vetëm në fillim të faqes fotografinë, ju lutem.

PY. Z. Dëshmitar, a e shikon një fotografi në ekranin që keni përpara?

PË. Po.

PY. A njeh atë çfarë jepet në këtë fotografi? E ke parë më përpara këtë vend?

PË. Po.

PY. Çfarë njeh, çfarë ke parë?

PË. Kjo a hymja te shtabi i logjistikës.

PY. Pra, kjo është hyrja në shtabin e logjistikës që diskutuam pak më përpara, kështu?

PË. Po.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshiroj që të kalojmë dhe ta shohim edhe njëherë skicën me numër identifikimi ERN 0853 [sipas përkthimit] deri në 083536 RED.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

lutem, Sekretar, le të kalojmë tek prova tjetër materiale.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, po shohim të njëjtën pamje që pamë më përpara, të njëjtën skicë që pamë më përpara.

Në të majtë të hyrjes, është vizatuar një kuadrat i vogël që është shënuar dhe H dhe një germë H dhe M. E shikoni është ky kuadrati që është me të zezë?

PË. Po.

PY. Çfarë është kjo?

PË. Kjo është barakë e rojës.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] A mund t'i jepet mundësia dëshmitarit, ju lutem që të vërë shifrën 6 tek ky kuadrat?

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Duhet të përdorim dokumentin që u shënua pak më përpara apo?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po, do ishte shumë mirë në qoftë se e bënë.

PY. Dëshmitar, ju lutem a mund të shënoni këtë vendin ku bënit roje me shifrën 6, këtë bajraken që thatë.

PË. [Shënon]

PY. Faleminderit.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, kam edhe një pyetje lidhur me baraken ku bënit roje. Ju lutem a mund të konfirmoni se këtu ju bënit

roje kur kishit turnin tuaj?
PË. Edhe njëherë znj. Prokurore, se s'e kuptova pyetjen?
PY. Sigurisht. A mund të konfirmoni se kur ishit roje qëndronit tek ky vendi që e shënuat me numrin 6?
PË. Po.
PY. Faleminderit.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Tani do kërkoj që të shfaqet dokumenti me numër material ERN 065597 deri në 065612. Edhe ky dokument nuk duhet të transmetohet për publikun.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem vazhdoni, z. Sekretar.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshmitarit t'i tregohet fotografia në fillim të faqes 065597.

PY. Z. Dëshmitar, a shikoni një fotografi në ekran?
PË. Po.
PY. A njihni këtë që ju tregohet në këtë fotografi, e keni parë më përpara?
PË. Po.
PY. Çfarë njihni, çfarë keni parë përpara?
PË. Kjo a këtu ku bëjsha roje unë. Gllavna kapia është. Kapia kryesore, znj. Prokurore.
PY. Pra, ky është vendi ku ti bëje roje, kështu, këtë që diskutuam?
PË. Po.
PY. Faleminderit.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Do i kthehemi edhe një herë skicës. Ju lutem t'i tregohet dëshmitarit prova materiale me numër identifikimi ERN 083536 deri në 083556 RED. A mund t'i tregohet i plotë në ekran ose përpara dëshmitarit? Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, mbi atë që ju e identifikuat si vendi ku vendi bënit roje, keni vizatuar një kuadrat me ngjyrë të kuqe që ka numrin 4. Na e shpjegon dot ju lutem se çfarë është kjo godinë, kjo ndërtesë?

PË. Kjo është aty ku flejshim ne. Edhe oficerët ku flejshin.

PY. Sa kate kishte kjo ndërtesë?

PË. Dy katëshe.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dua të transmetohet dokumenti me numër identifikimi ERN 065597 deri në numrin 065612, këtaj here kërkoj që dëshmitarit t'i tregohet fotografia në fund të faqes në faqen 065597.

PY. Dëshmitar, a shikon një fotografi në ekran?

PË. Po.

PY. A e njihni, e keni parë më përpara këtë godinë, këtë ndërtesë?

PË. Po, po.

PY. Çfarë është kjo? Çfarë shihni?

PË. Kjo që flejshim ne ushtria edhe që bëjshim roje te kapia.

PY. A mund të na e shpjegosh pak në më tepër hollësi mënyrën sesi ishte organizuar nga jashtë kjo ndërtesë?

PË. Si po mendoni? Se s'e kuptova pyetjen dhe njëherë, znj. Prokurore?

PY. Sigurisht. A mund të na japësh pak më shumë informacion për mënyrën sesi ishte organizuar nga brenda kjo godina, kjo ndërtesa, për shembull, ku flinit ju, ku ishin zyrat, si ishte organizuar brenda për brenda ndërtesa?

PË. Po. Na flijshim në katin e dytë. Oficerët flijshin në katin e parë. Demek këto dritaret që po shihen, kjo a kanë zyra e Sali Saramatit. Kjo dritarja këtu është hodniki. Pak ma brenda, nja 10 metra, flejshin oficerët.

PY. Thatë që ju flinit në katin e dytë. Sa vetë ishit ju që flinit në katin e dytë?

PË. Po këqyre tash 30, 25. Se u bëjshin transport ushtria. Herë u mbushke, herë u shpraske. Veç nën 20, 30 s'jemi kanë kurrë.

PY. Po dhomat ku flinit si ishin ato?

PË. Dhoma e madhe.

PY. Ju të gjithë flinit në një dhomë të vetme?

PË. Të gjithë në një dhomë.

PY. Po oficerët ku flinin?

PË. Oficerët, poshtë.

PY. Edhe oficerët flinin të gjithë në një dhomë të vetme apo kishin dhoma të veçanta?

PË. Jo, jo. Oficerët kanë pasë dhoma më të vogla, të veçanta kanë pasë. Se nalt na ku flijshim, ka pasë abullanta, ka pasë

mjekë që na këqyrshin.

PY. Edhe doktorët rrinin lart apo ku rrinin doktorët?

PË. Doktorët rrinë në katin e dytë, veç aty s'kanë flejtë doktorët. Kanë flejtë jashtë shtabit. Ka qenë një dhomë që për të smut. Ka qenë edhe një dhomë për të smut veçantë, a kanë qështu 3 me 3 ose 3 me 4.

PY. Faleminderit.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Tani të shkojmë prapë tek ajo skica.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më lejoni për një çast që të vazhdoj me atë fotografinë sepse dëshmitari në faqen 26 të transkriptit në rreshtin 1 dhe 2 tha:

"Me këto dritaret që shihen, aty qe zyra e Sali Saramatit".

Do të ishte mirë që dëshmitari ta shënonte me laps se për cilën dritare po flet, sepse unë shoh që ka disa dritare aty.

Dhe ai tha:

"Ajo dritarja aty" dhe pastaj më duket se ka dhe një gabim të shkruar. Prandaj do t'ju thosha që ta pyesnit dëshmitarin, t'i kërkonit dëshmitarit që ta shënonte me një numër dritaren e zyrës së Sali Saramatit. Dhe kur thotë "dritarja aty", e kujt ishte ajo dritare, për këtë e ka fjalën. Aty përmend dhe fjalën "hodnik", ça do me thënë kjo hodniku.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] T'i jepet dëshmitarit dhe një herë ajo pamja që është në ekran, por e shkruar në letër.

PY. Z. Dëshmitar, atë fotografinë që ke aty përpara, aty është e njëjta ndërtesë që është edhe në ekran ku e ke ti përpara. Ju na thatë se një nga ato dritaret ishte e zyrës së Saramatit. A mund të na thoni se cila ishte dritarja e zyrës së Saramatit?

PË. Po.

PY. Të lutem aty bëj një rreth te dritarja që thua dhe vë germën A.

PË. [Shënon]

PY. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A na i tregoni dhe një herë, ju lutem, sepse nuk e shoh nga aq larg aq mirë. Afroheni afër kamerës. Shoh tre dritare që janë rrethakuar dhe germa A, po e shikoj tani edhe germën A. Është e qartë. Faleminderit.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, po në atë fotografi ti përmende dhe një dritare të një zyre tjetër. E kujt ishte ajo zyrë dhe për cilën dritare e ke fjalën?

PË. Kjo dritarja tjetër është e korridorit. Na i thojmë hodnik, ju i thoni korridor. Korridoret aty flejshin oficerët, në krah të djathtë e në krah të shmajtë, i kanë pasë katër dhoma.

PY. Ju lutem rrethakoheni prapë atë dritaren që po thu dhe vërë germën B.
PË. [Shënon]
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Sekretare. Shoh që aty është rrethakuar një dritare pranë tre atyre dritareve dhe i është vënë germa B. Tani e kemi të qartë.
Vazhdoni, znj. Prokurore.
ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dua që përsëri të shohim atë skicën, pra, është prova me numrin 3536 deri në 83536 RED.
PY. Z. Dëshmitar, në majë të asaj ndërtesës ku flinit ju dhe ku flinin ata oficerët poshtë me numrin 4, ka dhe një kuadrat tjetër. A mund të na tregoni se cila është kjo ndërtesë me numrin 3?
PË. Po. Kjo ndërtesë është -- ka qenë kuzhina. Po edhe vijshin ata oficerët e mëdhej, demek oficerët e mëdhej. Ne as nuk kemi pasë shans me u taku me ta.
PY. A kishte ndonjë korridor që lidhte ndërtesën 3 me ndërtesën 4, si lidheshin?
PË. Jo. Jo.
PY. Aty në fillim të skicës shohim dy viza paralele dhe numrin 2 në mes. Çfarë tregon ai?
PË. Numri 2 tregon se ato magazinat, kanë qenë magazina.
PY. A e dini rastësisht se çfarë mbahej në këto magazina?
PË. Me një depo kanë qenë uniformat e Ushtrisë Çlirimtare.

Ato tjerat s'i di ça kanë qenë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Edhe njëherë dua që të shfaqet prova materiale 065600 dhe dëshmitarit t'i tregohet kjo pamje.

PY. Z. Dëshmitar, e shikon në ekran një fotografi?

PË. Po.

PY. A e njeh se çfarë ka aty, a e di se çfarë ka aty në mes?

PË. Po.

PY. A mund të na thuash se cila është kjo ndërtesë ose çfarë tregon kjo ndërtesë?

PË. Kjo ndërtesë magazinë është.

PY. E keni fjalën për atë magazinën për të cilën sapo folëm?

PË. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, për të qenë e qartë dua që dëshmitari ta rrethojë vendin ku është depoja apo magazina që të jemi të qartë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

Dëshmitarit t'i jepet, ju lutem, një fotografi e kësaj pamjes që shikojmë ne në ekran që ta shënojë aty. Është faqja 065600.

PY. Z. Dëshmitar, ju lutem rrethakoni aty në fotografi vendin ku është magazina.

PË. [Shënon]

PY. Tek kjo skica që ke vizatu ke një numër 2 midis atyre dy vizave dhe më përpara na the që është magazina. Është e njëjta ndërtesë, si kjo që sheh këtu, ajo që ke shënu aty?

PË. Po, e njëjta është.

PY. Ju lutem shënoni një numër 2 aty ke rrethi që sapo bëtë.

PË. [Shënon]

ZNJ. WYLER: [Përkthim] E shikoni numrin 2. Po. Shumë mirë. Faleminderit.

Tani t'i kthehemi edhe njëherë skicës. Pra, është prova materiale me numër ERN 083536 deri në 08 [sipas përkthimit], përafërsisht.

PY. Z. Dëshmitar, midis gjithë këtyre kuadrateve të kuqe ka një hapësirë bosh. Çfarë është ajo? Çfarë tregon?

PË. Ajo tregon oborri është.

PY. Meqë nuk ka një numër, a mund t'i vësh oborrit një numër, numrin 7.

PË. [Shënon]

PY. Faleminderit.

Në anën e djathtë të skicës, ka dhe një rreth me numrin 1 - më fal – një kuadrat me numrin 1. A mund të na i shpjegosh se çfarë është?

PË. Po. Kjo ka qenë një shtëpi. Ka qenë me dy dhoma. Ka qenë një shtëpi me dy dhoma ka qenë.

PY. Sa kate kishte ajo shtëpi?

PË. Një katëshe.

PY. A e dini ju se përse ishte kjo shtëpia aty, për ça shërbente?

PË. Po. Kjo shërbejke për të dyshumtë që vijshin me u kyç në

UÇK e i merrshin në pyetje. Ka pasë Serbia që i ka çu informata për me marrë.

PY. Pra, njerëzit që mbaheshin ke ndërtesa numër 1, aty rrinin me dëshirën e tyre?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Më fal që ju ndërpres. Po është një pyetje sugjestionuese.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për një moment do ta shkëpusim lidhjen, do ta diskutojmë. Ose ndryshe mund ta riformuloni pyetjen, Prokurore.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju kërkoj një minutë.

Mund ta riformuloj pyetjen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptoj këtë që thoni.

Vazhdoni, Prokurore.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, tek kjo ndërtesa me numër 1, aty njerëzit flinin?

PË. Jo, jo. Me flejtë jo. Po i mirrshin në pyetje ka dy-tre orë i mbajshin aty dhe i lëshojshin.

PY. E çfarë do të thuash kur thua "i mbajshin aty"?

PË. Po se ka pasë që i ka dërgu dhe Serbia për informata.

PY. Si trajtoheshin këta njerëz nga UÇK-ja?

PË. Po i mirrshin në pyetje dhe i lëshojshin. Që ata oficerët e mëdhenj e dijshin që nuk është i dyshimtë u ndalke, u veshke

në rroba të UÇK-së. Ata që dyshojke i përzike.

PY. Ju thatë që mbaheshin aty. Po a kishin të drejtë me ik nga ajo ndërtesë vetë?

PË. Jo, jo. S'ka shans me ik.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dua që të shohim provën materiale me numër ERN 074390 deri në 074391.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshmitarit t'i tregohet fotografia në faqen 074390. Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, a e sheh atë fotografinë që ke përpara?

PË. Po.

PY. A e njeh këtë që shikon këtu?

PË. Po.

PY. Çfarë është ajo?

PË. Po që kjo dhoma ka qenë që si dhomë hetuese, që i thashë pak më parë, që i mirrshin i pyetje. E këtu i mëshilshin, a po merr vesh, ka dy-tre orë.

PY. Pra, kjo është ndërtesa që në skicën që ke vizatuar ka numrin 1, vendi ku i mbanin njerëzit për t'i marrë në pyetje, kështu?

PË. Po.

PY. A ju kujtohet afërsisht sa larg ishte kjo ndërtesë nga ndërtesa ku flinit ju dhe ku qëndronin oficerët, sa metra larg ishte?

PË. 15 deri në 20 metra, më tepër s'ka pasë.

PY. Ju na thatë që ndërtesa kishte dy dhoma. A mund të na i përshkruash më me detaje, më me hollësi, brenda sesi ishte? Di diçka më shumë?

PË. Po një dhomë a kanë qe kjo dhe një dhomë a kanë mbrapa kësaja, që shihen këtu edhe dritaret ku janë. Shihen. Si puntori a kanë.

PY. Nga ajo që shikon që na thua ishte si puntori, çfarë duket aty në dritare, ça shef aty?

PË. Kurrgjë. Këtu i shof hekrat veç. Derën e shof. Dhe ato dy dritaret atje në skaj që janë.

PY. Thatë që shihni një derë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju lutem jepini dëshmitarit një fotografi të shtypur që tregon këtë pamjen këtu. Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, ju lutem shënoheni vendin ku është dera.

PË. [Shënon]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] E ka shënuar me ngjyrë blu. Është e qartë apo të përdorim një ngjyrë tjetër?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E shohim. Nuk e di nëse ndonjë koleg tjetër nuk e sheh. Mbrojtja thotë, po, po dhe Prokuroria thotë, po. Besoj që dhe Mbrojtësi i Viktimave thotë, po.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. I thoni dëshmitarit, ju lutem, të vendosi germën A te rrethi.

PË. [Shënon]

PY. Z. Dëshmitar, na the që shikon dhe ca dritare me hekura. A mund të na i tregosh se ku kishte hekura, në të gjitha dritaret apo në disa vetëm?

PË. Veç këto dyja kanë pasë.

PY. Në rregull. Nuk ke nevojë ta shënosh. Faleminderit.
Ju na thatë se kishte dy dhoma. A të kujtohet sa të mëdha ishin këto dhomat?

PË. Po tash me mat s'i kam mat, se kam shumë kohë, 5 me 4 qashtu. Ma të mëdhaja s'kanë qenë.

PY. Si ishte gjendja në këto dhomat, në çfarë gjendje ishin këto dhomat?

PË. Po në atë kohë, sidomos në atë kohë, s'janë kanë edhe bash në gjendja të këqija, të mira janë kanë. S'janë kanë bash në gjendje të këqija, të mira janë kanë. Për me flejtë ka mujt njëri me flejtë në to.

PY. Vetë a i ke parë me sytë e tu ndonjëherë dhomat nga brenda?

PË. Po.

PY. A mund të na i përshkruash se çfarë ke parë atëherë?

PË. Po kanë qenë dërrasa, pato si kanë, pato dërrasa ka qenë. Me e ly, e lyne me qereç ka qenë. Jo pashë qatë kështu. Po me takat njëri qa -- për me flejtë kanë bë.

PY. Kur thua që "mund të bëjshin me fjetë" ça ke parasysh me këto fjalë?

PË. Dërrasa. Kurrgjë tjetër.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E keni fjalën dyshemeja ishte me dërrasa?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Podi. Podi na i thojmë podi. Podi me dërrasa. Kreveta s'ka pasë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] S'e kam shumë të qartë, z. Dëshmitar. Ça ke parasysh me podin prej druri? Ku ishin ato?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Që të dhomën e parë 5 me 4. Po na i thojmë pod a patos a. Unë s'di qysh i thoni ju, znj. Gjyqtare. Demek ciment poshtë s'a kanë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Thatë që nuk kishte shtretër aty - në qoftë se gabohem më korrigjo – po unë e kuptova që njerëzit flinin në dysheme, kështu?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Ushtria po. Se kjo parket s'ka pasë, dërrasa ka pasë. Këtu asnjë ushtarë s'ka flejtë. Na e kemi pasë padiljonin të veçantë. Këtu veç hetime kanë marrë ata komandantët e mëdhenj. E kanë dyshu që e ka çu Serbia me marr kurrfarë informate e send.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit që e shpjeguat.

Mund të vazhdoni. Unë kam dhe pyetje tjera, po ndërkohë vazhdoni, Prokurore.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, sa herë të ka qëllu me shku ke kjo ndërtesa

në drejtorinë e logjistikës në Kukës?

PË. Te kjo ndërtesa dy herë krejt jam kanë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kam parasysh kohën. Jemi tre minuta para pushimit, por mbase do të ishte kohë e mirë të bënim pushim tani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë, znj. Prokurore.

Z. Dëshmitar, tani do të bëjmë një pushim prej 30 minutash. Sekretarja do t'ju shoqërojë jashtë nga vendi ku jeni tani. Dhe do të shihemi përsëri në orën 11.30. Faleminderit.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të rifillojmë mbas 30 minutash.

--- Pauza fillon në orën 10.58

--- Seanca rillon në orën 11.31

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u kthyet.

Znj. Sekretare që gjendesh në vendin në distancë, ju lutem, a mund ta ktheni përsëri Dëshmitarin?

Z. Shala, na dëgjon?

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Shala, na dëgjon?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, ju dëgjon.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po shoh në qoftë se ka ndonjë ndryshim në përbërjen e ekipeve të Mbrojtjes. Nuk ka ndryshim te Prokuroria, nuk ka ndryshim as te Mbrojta e Viktimave dhe as te Mbrojtja e të Akuzuarit.

Z. Shala, na dëgjon dhe është i pranishëm përmes videolidhjes.

Z. Dëshmitar, mirë se erdhët! A na dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, mirë se ju gjeta!

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të vazhdojmë me dëshminë e Dëshmitarit 10.

Znj. Prokurore, përpara sesa të fillojmë lidhur me skicën, kur të përfundoni me skicën, ju lutem, na thoni në mënyrë të tillë që kur të keni përfunduar me të, Sekretari i Seancës të mund të na bëjë me dije se cili është numri ERN që do i caktohet kësaj skice në momentin kur ajo të bëhet provë materiale.

Sa i takon skicës dëshiroj që të bëni një pyetje, domethënë te ky kuadrati 3 në të majtë të skicës ka disa shifra tek 3-shi, d.m.th. është nuk e di në qoftë se doni që të bëni një pyetje për të përcaktuar me saktësi apo për të shpjeguar se cilat këto, domethënë, çfarë duan të thonë këto akronimet HH, SS e kështu me radhë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po, në rregull. A mund të kërkoj që të shfaqet në ekran prova materiale me ERN 083536 deri në

083536, ju lutem, edhe një herë.

PY. Z. Dëshmitar, në ekran, edhe një herë, a e shikoni skicën e organizimit të shtabit logjistik në Kukës?

PË. Po.

PY. Kur shohim te ndërtesa me numrin 4, kjo ndërtesa ku flinit ju dhe oficerët. Aty janë bëra disa shënime me ngjyrë blu të errët ose me ngjyrë të zezë. Pra, është HH, DZK dhe pastaj SS. A i shikoni këto shënime, ju lutem?

PË. Po.

PY. A mund të na shpjegoni, së pari, çfarë do të thotë HH?

PË. Për sa më kujtohet mua, është hodniki.

PY. Po pse janë dy "H"? Mund të na e shpjegosh se çfarë ke dash të thuash me shënimin e dy H-ve?

PË. Thashë, znj. Prokurore, shumë vite ka kaluar. Tash me ma tregue atë shtëpinë edhe një herë, ku janë konë zyrat Sali Saramatit më mirë e kisha sqaru dhe kisha tregu ma mirë. Që tash kam harru, tash edhe vetë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, unë dua të di, se çfarë do të thotë HH? Çfarë ke dash të thuash ti kur ke shënuar HH? Mua më duket sikur është një shkurtim për diçka. Çfarë është HH-ja?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Znj. Gjyqtare, kjo mundet me u konë veç hodniki.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Po DZK? Çfarë është DZK-ja? Për çfarë e ke përdorur?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Znj. Kryegjykatëse, ju lutem, a mundet të fillojmë me HH-në, në fund fare të skicës, në qoftë se është e mundur?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po, në rregull, por nuk dua që të marrë shumë kohë me këtë pyetje. Faleminderit.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, a shikon një SS në fund fare të kësaj kuadrati, do të thotë ndërtesës 4? Ke bërë një shënim SS, e sheh?

PË. E kam harruar znj. Prokurore.

PY. A të kujtohet se për çfarë e ke shënuar, e ke bërë këtë shënim SS?

PË. Jo.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Znj. Kryegjykatëse, a mund t'ia kujtoj pak Dëshmitarit?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshiroj që të shfaqet në ekran prova materiale 083537-TR-ET, Pjesa 1, faqja është 21. Nuk e kemi pjesën në shqip, megjithatë, mund t'jua japin si referencë më vonë.

PY. Z. Dëshmitar, gjatë intervistës që i ke dhënë ZPS-së në vitin 2019, ju është bërë pyetja që pasqyrohet në rreshtin 5.

"Kë tjetër patë kur keni arritur për herën e parë?"
Edhe ke dhënë përgjigje:
"Hafir Hoxha".
"A mund të vendosni HH ku ka qëndruar ky person?".
Dhe më pas keni bërë shënimin "HH" në skicën që keni pas përpara. A të kujtohet kjo?
PË. Po.
PY. A mundet të jetë që HH-ja në ndërtesën 4 është vendosur si shkurtim për Hafir Hoxhën?
PË. Po.
PY. Duke iu kthyer SS-së, shënimit që është bërë në fund të ndërtesës që ka shënimin 4. Dhe duke pasur parasysh që ti më herët e ke shënuar zyrën e Sali Saramatit në ndërtesën 4, a mund të ndodhë që SS-ja të jetë përdorur si shkurtim për Sali Saramatin?
PË. Po.
PY. T'i kthehemi përsëri skicës, dokumentit 083536 deri në 083536 RED, në mes të SS-së dhe HH-së, në mes diku aty ke shënuar DZK. Për çfarë i ke vendosur, çfarë duan të thonë këto tri germa, DZK?
PË. S'më kujtohet znj. Prokurore.
PY. Z. Dëshmitar, a mund të ndodhë që ky akronim DZ reflekton emrin dhe K-ja mbiemrin, a mund të ndodhë që të jetë shkurtimi për Xhemshit Krasniqin ky?
PË. S'e di, kam harru tash. S'e mbaj mend.

Znj. WYLER: [Përkthim] Të transmetohet prova materiale 083537-TR-ET, Pjesa 1, faqe 21. Të shohim rreshtin 20. Jo, në fakt është rreshti 18. Pyetja është kjo:

"Kë patë tjetër kur arrite për herën të parë në këtë pavijon, në pavijonin dy?".

Përgjigja është:

"Pashë Xhemshit Krasniqin".

Pastaj pyetja është:

"Në qoftë se mund të vendosësh një X dhe K ku e ke parë atë".

Dhe më pas Dëshmitari ka bërë shënjimin në skicë edhe ka bërë këtë shënimin DZ që i përkon emrit Xhemshit dhe K-ja për Krasniqin.

Pastaj vazhdon më tej:

"Duket që të gjithë që keni parë juve kanë qenë brenda ndërtesës 4, kështu është?

Dhe ai e konfirmon, dhe thotë "Po".

PË. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, tani t'u kujtua që e keni thënë këtë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, po m'u kujtua.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Ju kujtoj, z. Dëshmitar, që jeni këtu për të thënë të vërtetën. Dhe e thashë në fillim fare që në qoftë se nuk ju

kujtohet nuk është e thënë që të sajosh. Por kjo nuk do të thotë që ti të mos përpiqesh fort për t'u kujtuar. Dhe në këtë rast ose në përgjithësi, do thosha, që do ju kërkoja që të thoni të vërtetën.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Në rregull. Kaq kisha lidhur me skicën. Në qoftë se nuk ka pyetje të tjera ose nëse nuk nevojitet shënjimet të tjera për t'u bërë në skicë kam përfunduar me skicën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Trupi Gjykues mund të ketë pyetje në një fazë tjetër të mëvonshme, por për momentin nuk do të bëjmë pyetje, sepse nuk duam që të ndërpresim marrjen në pyetje të Dëshmitarit prej jush.

Z. Sekretar, mbi bazën e asaj çfarë na tha ZPS-së që ka përfunduar me këtë skicë, pra, ka përfunduar pyetjen e Dëshmitarit lidhur me skicën, ju lutem, a mund t'i caktoni një numër ERN skicës?

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Faleminderit të nderuar Gjykatës. Skica me ERN 083537-TR-ET RED me shënimet e bëra nga Dëshmitari merr numrin ERN 00947 ERN REG0047.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, I referohem transkriptit të përkohshëm,

faqe 36, rreshtat 22 deri në 23, përpara pushimit, kur thatë që ju keni qenë vetë në ndërtesën që keni shënuar si ndërtesa nr. 1 në skemën që keni hartuar vetëm dy herë. Pse ke shkuar në këtë ndërtesë? Cila ka qenë arsyeja pse ke shkuar në këtë ndërtesë?

PË. Veç me e këqyr, kurrgjë tjetër. Veç me e këqyr.

PY. A kishte njerëz aty brenda kur ke shkuar? Brenda ndërtesës kishte njerëz?

PË. Po, sefte kur kam...

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Thjesht doja të thoja që është pyetje sygjestionuese, ndoshta të bëhet një pyetje me fund të hapur, në vend të kësaj pyetje. Si p.sh. çfarë patë në ndërtesë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë, pranohet. Ju lutem, shpreheni ndryshe, parafrazojeni pyetjen.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, çfarë patë ju në ndërtesë kur shkuat aty?

PË. Sefte kur kam shkue aty, kam hy e kam këqyr. Sefte kur kam ardhë në Kukës, në logjistikë.

PY. Dhe çfarë patë, çfarë kishte aty?

PË. Dhoma të zbrazëta.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshiroj që të transmetohet prova materiale ERN 108836-TR-ET, Pjesa 1 RED, faqe 14.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

lutem, vazhdoni z. Sekretar.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Përkthimi në gjuhën shqipe është në faqen 17.

PY. Dëshmitar, sapo na thatë që herën e parë kur keni shkuar aty dhoma ishte bosh. Po herën e dytë kur shkove, çfarë patë, çfarë kishte aty?

PË. Por ma vonë, pas ditësh, ma vona, ka pas qështu në pyetje çka i merrshin.

PY. A mund të na përshkruash pak me më shumë hollësi se si dukeshin këta njerëz, çfarë pamje kishin këta njerëz?

PË. Po njerëz kish 30-vjeçarë, 25-vjeçarë, 18-vjeçarë edhe 40-vjeçarë ka pasë.

PY. A kishin ndonjë karakteristikë konkrete këta njerëz, kishin ndonjë gjë specifike?

PË. Jo.

PY. Në faqen 14 të provës materiale në versionin anglisht, rreshtat 22 deri në 23. Të bëhej pyetja:

"A e keni idenë se çfarë pamje kishte kjo ndërtesë nga brenda, si dukej nga brenda kjo ndërtesë?".

Dhe tani shkoj te faqja 15, rreshti 1. Përgjigjesh:

"E kam parë vetëm një herë përmes dritares".

Dhe pastaj vazhdoni në rreshtat nga 8 deri në 10, në përkthimin në shqip është rreshti 20 deri 21. Thua, po, keni shoqëruar një tjetër ushtar të UÇK-së.

"Nuk kam qenë vetëm unë, ka qenë një tjetër ushtar dhe

thjesht e kam shoqëruar atë për t'u siguruar që personi nuk do të largohej. Për këtë arsye isha aty".

A të kujtohet që e ke thënë këtë?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Përpara sesa Dëshmitari të japë përgjigje, thjesht dua të di se çfarë vlere ka që i tregojmë Dëshmitarit dëshminë e mëparshme të tij. Thjesht për ta kujtuar, sepse kjo është diçka të cilin nuk e kemi prekur fare.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Me sa kuptova unë, megjithatë, ndoshta do të ishte më mirë që t'i kërkoja ZPS-së që të përgjigjet. Domethënë, nuk është se është pyetje për mua. Le t'i përgjigjet ZPS-ja.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshmitari tha fillimisht që nuk shkoi për një qëllim konkret aty. Ndërkohë që në deklaratën e mëparshme ka thënë që ka qenë për një qëllim konkret. Për këtë arsye ia solla në vëmendje atë çfarë ka thënë në dëshminë e vet.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E sqaron kjo përgjigje e Prokurores pyetjen tuaj?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, a ju kujtohet ta keni thënë këtë? E mbani mend se e keni thënë këtë?

PË. Ndoshta e kam thënë, kam harrue.

PY. T'ju bëj edhe një herë pyetjen: a ka pas ndonjë qëllim të caktuar pse shkuat te ndërtesa që e keni shënuar me nr. 1 në skicën që keni bërë vetë?

PË. Ajo është kur kam shkue te dritaret, znj. Prokurore. Ajo, ma vonë kam shkue te dritaret. Kur kam shkue në fillim, kam hy në dhomë e kam këqyr çfarë dhome është. A kur kam shku te dritaret me këqyr prej dritares aty ka pas gjind.

PY. Përmendët që herën e dytë, kjo ka ndodhur kur keni shkuar herën e dytë në ndërtesë. A mund të na shpjegoni se pse, për çfarë qëllimi keni shkuar në ndërtesë herën e dytë? Për çfarë qëllimi konkret keni shkuar?

PË. Jo, kurrgjë, kurrgjë. Veq me këqyr kush është brenda.

PY. Thatë që keni parë gjind, keni parë njerëz aty brenda herën e dytë që shkuat në ndërtesë. Sa njerëz patë, sa vetë ishin aty?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, a mund ta heqim dëshminë?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, znj. Prokurore.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. A mund të na thoni se sa gjind, sa njerëz kishte në atë dhomë?

PË. Thashë, mas shumti se pesë vetë, s'ka pasë.

PY. Ju na keni dhënë ca informacion lidhur me këtë, por

thjesht sa për ta sqaruar këtë në procesverbal. A e dini ju se pse mbaheshin ata njerëz në atë dhomë?

PË. Po. Ata mbaheshin në dhomë si të dyshimtë. Ka qenë dhomë e të dyshimtëve. Demek mos ka çu Serbia ndonjë informatë me marrë qështu.

PY. Kur thoni që ishin "të dyshimtë", për çfarë dyshoheshin ata?

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që ju ndërpres, por mendoj që Dëshmitari iu përgjigj pyetjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, nuk i është përgjigjur. Ju lutem, vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, e përsëris edhe një herë pyetjen: Ju thatë që ishin të dyshimtë, të dyshuar. Për çfarë dyshoheshin këta?

PË. Po, dyshoheshin mos i ka çu Serbia për ndonjë informatë.

PY. A quheshin me ndonjë emër të veçanta ata, d.m.th. UÇK-ja që ishte e pranishme në Kukës i quajte, kishte ndonjë emër të veçantë që i quante ata, që i thërriste ata?

PË. Jo, jo veç të dyshimtë, kurrgjë. Veç i dyshimtë.

PY. Thatë që mbaheshin në dhomë për të verifikuar në qoftë se kishin bërë atë për të cilën ishin dyshuar. Çfarë do të thotë, për të verifikuar? Si bëhej verifikimi?

PË. Po tash, ata e dinë ata të mëdhenjtë, ata komandantët e mëdhenj, si bëhet verifikimi, por unë që aq, që aq kam informata, qa aq di që, ma tepër s'di kurrgjo.

PY. Kur e ke fjalën për këta më të mëdhenjtë e ke fjalën për komandantët? Po kush kujdesej për verifikimin e këtij informacioni, a e di ti se kush merrej me verifikimin e këtij informacioni?

PË. Po q'ata komandantët që kanë qenë në Kukës.

PY. A të kujtohet ndonjë emër?

PË. Po.

PY. Ju lutem, a mund të na i thoni çfarë të kujtohet?

PË. Po. Xhemshit Krasniqi, Sali Saramati, Hafir Hoxha.

PY. Po thua ose thatë për përpara që njerëzit merreshin në pyetje në ndërtesën me nr. 1. A kishte ndonjë vend tjetër aty ku bëheshin marrjet në pyetje?

PË. Jo.

PY. Nga e morët vesh se këta njerëzit që mbaheshin në ndërtesën nr. 1 merreshin në pyetje? E ke parë vetë me sytë e tua këtë gjë?

PË. Po i lëshojshin se kam qellu, një dite a dy kam qëllu kujdestar kam qëllu unë tek [e pakuptueshme]. E ku dilshin i vehtsha, thojnë n'pytje m'kanë marrë, thojshin. Ne s'kemi lidhje me Serbinë.

PY. Ti nga e ke marrë vesh që atyre u janë bërë këto pyetje? Si e mësove ti që atyre u janë bërë këto pyetje?

PË. Po i lëshojshin, i merrshin në pyetje dhe i lëshojshin. E tek apia unë i bëjsha pyetje, ku po shkon, thojke më lëshutën, thojke, më kanë marri si të dyshimtë mos kam lidhje me

Serbinë.

PY. Nëse të kuptova drejt, atëherë kur ti ishe roje, tek porta, te shtabi logjistik, njerëzit që intervistoheshin ose që merreshin në pyetje nga këta komandantë, ta kanë dhënë ata këtë informacion, kështu thatë apo jo?

PË. Po.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] A mund të kalojmë në seancë private për disa pyetje të nderuar Gjykatës?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe në fillim të seancës do të na shpjegosh se përse po e bëjmë këtë.

Z. Sekretar të kalojmë në seancë private, ju lutem.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit. Vazhdoni znj. Prokurore.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Z. Dëshmitar, sapo na thatë që e patë Pjetër Shalën në shtabin e logjistikës në Kukës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që Dëshmitari të jetë i qartë.

Z. Dëshmitar, tani jemi në seancë publike prapë. Pra, ki kujdes kur të përmendësh ndonjë emër apo ndonjë informacion që mund të identifikojë njeri.

Vazhdoni znj. Prokurore.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, sapo thatë që e patë Pjetër Shalën në shtabin e logjistikës në Kukës. Sa herë nëse e ke parë më shumë se një herë, sa herë e ka parë Pjetër Shalën aty?

PË. Nja dy herë, jo ma së shumti.

PY. A të kujtohet kur e ke parë një herë, të kujtohet kur e ke parë herën e dytë se çfarë muaji ka qenë?

PË. Ka qenë qaty ka i pesti, i pesti ose i gjashti [e pakuptueshme] muaji i gjashtë.

PY. Pra, e kuptova drejt që të dy herët që na përmende ka ndodhur njëra në maj, njëra në qershor ’99, kështu?

PË. S’e kuptova pyetjen znj. Prokurore. Ç’ka deshtë me thanë “maj”?

PY. A është e saktë të themi se të dy herët që e ke parë Pjetër Shalën në shtabin e logjistikës, të dy herët kanë qenë o në muajin e pestë apo në muajin e gjashtë ’99?

PË. Saktë është, q'ashtu është.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të paraqitet deklaratë e mëparshme e Dëshmitarit. Kërkoj që të jepet në ekran prova materiale me numër identifikimi ERN 083537-TR-ET, Pjesa 2, në faqen 21.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila është arsyeja që kërkoni që të shfaqet kjo deklaratë e mëparshme e Dëshmitarit?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dëshiroj të sqaroj diçka me Dëshmitarin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faqja 21, rreshtat 13 deri në 14 në versionin në gjuhën angleze dhe faqja 28, rreshtat 8 deri në 9 në versionin në shqipe.

PY. Z. Dëshmitar, në deklaratën me ZPS-në në vitin 2019 ju bëhet kjo pyetje:

"A e mbani mend kur e keni parë atë për herë të parë", dhe kur thuhet "atë", bëhet fjalë për Pjetër Shalën. Pra, "A e mbani mend se kur e keni parë Pjetër Shalën dhe sa herë e keni parë atë?". Përgjigja që keni dhënë është kjo:

"Pjetër Shalën e kam parë 5-6 herë gjatë kohës që kam qenë atje. Ai ikte dhe dilte në Kukës".

E mban mend ta kesh thënë këtë?

PË. Por ndoshta e kam, ndoshta e kam thënë. Që tash kam harrue, edhe unë tash.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, një sekondë ju lutem. Dua t'ia jap fjalën Mbrojtjes.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë të nderuar Gjykatës. Këtu u lexua "gjatë kohës që kam qenë atje, sa kam qenë atje". Ndërkohë, që në intervistë mënyra se si shprehet është e ndryshme. Ndoshta duhet që ta vendosim në kontekst këtë pyetje. Pra, gjatë asaj kohe se ka goxha dallim nga mënyra se si bëhet pyetja.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit Avokat.

Znj. Prokurore, a mund ta trajtoni këtë shqetësim të Mbrojtjes në pyetjet tuaja?

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Për ta sqaruar z. Dëshmitar: Në shtabin e logjistikës në Kukës, kur e keni parë Pjetër Shalën atje?

*[REDAKTUAR]*

*[REDAKTUAR]*

PË. Të lutem, z. Dëshmitar, jemi në seancë publike. Ju lutem, mos përmendi emra personash.

Pra, e keni parë në të gjashtin dhe në të pestin në 1999 atëherë kur keni parë Pjetër Shalën disa herë. Dua ta sqaroj këtë: e keni parë vetëm dy herë, siç na the sot apo e keni parë më shumë sesa dy herë? A mund të ketë ndodhur që ta keni parë më shumë sesa dy herë Pjetër Shalën në vitin 1999?

PË. Mund të ndodhë ajo. Mund të ndodhë, ndoshta e kam parë, por kam harrue tash.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Për të qenë e drejtë me Dëshmitarin ndoshta mund t'i themi që në deklaratën e mëparshme ai ka thënë që "gjatë kohës që kam qenë atje, sa kam qenë atje". Ndërkohë që në pyetje ai flet konkretisht për majin dhe qershorin e vitit 1999. Ndoshta kjo sjell ndryshime në përgjigjen e tij.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, a e dini ju në qoftë se Pjetër Shala kishte ndonjë nofkë?

PË. Sa mbaj mend unë, "Uki", po më duket, po më duket "Uki".

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, dëshiroj t'i bëj një pyetje Dëshmitarit tani.

Z. Dëshmitari, kur ke qenë në Kukës, a të kujtohet sa shpesh e ke parë z. Shala?

DËSHMITARI: Mu sa më kujtohet nja dy herë. Ndoshta ka mundësi që e kam ndoshta edhe më shumë, por s'un më kujtohet tash.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit z. Dëshmitar. Në rregull, Mbrojtja? Në rregull. Vazhdojmë. Znj. Prokurore, vazhdoni më tej.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, sot na thatë se në ndërtesën 1 që e keni shënuar në skicën që ju treguam më herët, në këtë ndërtesë ndonjëherë mbaheshin njerëz që ishin të dyshuar, që mund të kishin bashkëpunim ose mund të kishin punë me serbët.

Dëshiroj që të paraqitet prova materiale ERN 083537-TR-ET, Pjesa 1, faqja 20. Përkthimi në shqipe është në faqen 26.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dhe kjo për sqarime.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që nuk e thashë. Po, për këtë gjë kërkoj.

PY. Z. Dëshmitar, në intervistën që i keni dhënë ZPS-së në vitin 2019, ju pyetën në qoftë se ndërtesa 1, nëse kjo ishte një ndërtesë të cilën ndoshta ju e keni identifikuar si punishte. Edhe ti ke thënë, po ishte kështu si punëtori. Ndërkohë në intervistën që i keni dhënë ZPS-së në vitin 2019 nuk duket se i jeni drejtuar ndërtesës si një vend që përdorej për të mbajtur njerëz, gjind aty. Po thjesht keni thënë që thjesht ka qenë si punëtori. Për çfarë arsye e keni thënë këtë Prokurorisë? Pse në vitin 2019 nuk i keni thënë Prokurorisë që kjo ndërtesë është përdorur për njerëz, për të mbajtur njerëz?

PË. Po ashtu kam dëgju që a kon si punëtori, e ashtu kam dëgju kur kam ardhë në Kukës.

PY. Cila është arsyeja që në vitin 2019 nuk e keni përmendur që kjo ndërtesë është përdorur gjithashtu edhe për të mbajtur njerëz që ishin të dyshuar?

PË. E kam thënë që është i dyshuar, por përkthimi ka qenë gabim.

PY. Pra, a thoni tani që ndërtesa është përdorur për persona të dyshimtë, por nuk është përkthyer atëherë? Këtë po thoni, e kuptoj drejt këtë?

PË. Ajo ka qenë, edhe një herë ta kem të qartë, znj. Prokurore. Ajo ka qenë si punëtori ka qenë. Tani u përdor për të dyshimtë. Këtë e kam thënë unë edhe ma herët, por përkthyesi ka qenë i dobët shumë. S'ka dit me e përkthy.

PY. A e kuptoj drejt që ajo çfarë na thatë sot është e vërteta, është ajo çfarë ka ndodhur në vitin 1999 në shtabin e logjistikës në Kukës, kështu? Ajo çfarë thatë sot është e vërteta, kështu?

PË. E vërtetë është.

PY. Na thatë po ashtu sot dhe përmend këtu transkriptin e përkohshëm në faqen 36, rreshti 22. Na thatë sot se ke qenë në ndërtesën nr. 1 dy herë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Dua të qartësoj një deklaratë të mëparshme me Dëshmitarin dhe dua që të paraqitet prova materiale ERN 083537-TR-ET, Pjesa 1 RED2, faqja 16.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni, ju lutem.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Përkthimi në shqipe është në faqen 21, rreshti 11. Ndërkohë që janë në rreshtin 9 në versionin në anglisht.

PY. Në intervistë me ZPS-në në vitin 2019, Prokurori ju bën pyetjen:

"Çfarë kishte aty brenda?" "Aty për brenda" e kishte fjalën për punëtorinë, në atë ndërtesën që ti i ke vënë nr. 1 në skicën.

Në rreshtin 10 në anglishte dhe 12 në versionin në shqip ti je përgjigj kështu:

"S'e di, s'jam konë aty brenda asnjëherë".

Ndërkohë që sot na thua që ke qenë dy herë, në dy raste ke qenë aty. Dhe që ke parë gjind, që ke parë njerëz aty brenda. A ka një arsye pse nuk i ke thënë Prokurorit, s'ia ke dhënë këtë informacion në vitin 2019?

PË. Kjo është e saktë çfarë po thoni ju tash. Përkthyesi s'ka dit me përkthy. Ajo ka qenë si punëtori, por a largu prej atyit dhomë e zbrazët ka qenë. Dy herë kam qenë unë, ka konë dhomë e zbrazët; kam këqyr, e, masanaj ka nis me ardhë gjind, znj. Prokurore, se gjashtë muaj kam nejt aty unë. Në fillim ashtë kon kjo. S'ka dit përkthyesja gabim është. Përkthyesi gabim ka qenë.

PY. Më herët sot na thatë se keni mësuar apo keni parë, keni mësuar që këta gjind që mbaheshin në ndërtesën 1 merreshin në pyetje. Kjo është në pajtim me atë çfarë na keni thënë në intervistën me ZPS-në të vitit 2022. Gjithsesi doja ta sqaroja.

Dhe dua t'i referohem një përgjigjeje që ka dhënë

Dëshmitari në intervistën e vitit 2022. Për këtë arsye dua që të paraqitet dokumenti ERN, Pjesa 1 RED2, faqja 29.

Z. AOUINI: [Përkthim] Thjesht duam të dimë, po bëjmë kundërpyetje Dëshmitarit vetë Prokuroria. Në qoftë se ky është rasti do duhet që të na e thotë këtë gjë Prokuroria.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk është nevoja për të kërkuar ndjesë, e para, dhe e dyta nuk shikoj ndonjë problem me pyetjen që po i bën Prokurorja.

ZNJ. CARIOLOU: [Përkthim] Në qoftë se më lejoni dua të shtoj diçka. Deklaratat e mëparshme nuk janë në prova materiale. Kështu që, në qoftë se qëllimi është që të sqarohet diçka që nuk është në deklaratë, ndoshta na duhet që të na jepet një shpjegim tjetër se pse po kthehemi mbrapsht për të sqaruar. Për çfarë, çfarë po kërkojmë që të sqarojmë? Thjesht sa për të kuptuar më mirë për çfarë bëhet fjalë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, ka ndonjë gjë që doni të shtoni lidhur me pyetjen e bërë?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ne po kërkojmë të vërtetën. Ndonjëherë kemi dëgjuar informacion sot që nuk është tërësisht në pajtim me atë çfarë ka thënë Dëshmitari në deklaratat e veta të mëparshme. Dhe thjesht për ta sqaruar, për ta qartësuar po e bëjmë këtë pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju shikoj Avokat që jeni në këmbë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Duhet që të dimë informacionin e plotë ose të themi çfarë pretendimi ka ZPS-ja. Sepse duket sikur kolegët e ZPS-së zgjedhin pjesë të caktuara që u shkojnë atyre për shtat dhe ka ca gjëra për të cilat ne duhet të njoftohemi paraprakisht.

Pyetja për sjelljen e transportit të personave është diçka që duhet të sqarohet në pretendimin e ZPS-së.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, a po bëni pyetje lidhur me sjelljen e personave? Se m'u krijua kjo përshtypje.

Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk po thonim këtë gjë, por thjesht po themi që nuk është e qartë se cili është qëllimi i Prokurorisë, d.m.th. po bën kundërpyetje Prokuroria për Dëshmitarin?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, nuk po bën kundërpyetje. Jemi këtu për të zbuluar të vërtetën, për të mësuar me vërtetësi se çfarë ka ndodhur. Kemi deklaratat e mëparshme të Dëshmitarit, kemi edhe Dëshmitarin këtu dhe vërejmë janë thanë gjëra sot të cilat mundet, nuk e di se na duhet të presim dhe të arrijmë në konstatime por mund të ketë mospërputhje. Dhe ZPS-ja, me çfarë kuptoj unë, po mundohet të sqarojë në mënyrë që të nxjerr në pah të vërtetën, çfarë ka ndodhur realisht. Unë nuk e shikoj këtë si kundërpyetje. Thjesht e shikoj si një mënyrë për të gjetur dhe për të zbuluar të vërtetën.

Për momentin për këtë pikë specifike mendoj që kemi dhënë qartësime të mjaftueshme. Argumenti i ngritur prej jush lidhur me përdorimin e fjalës "sjell", u munduam që ta rikuperojmë, që ta sqarojmë, që ta korrigjojmë ose të jemi sa më të saktë të jetë e mundur për praninë, sepse e kuptova shqetësimin e ngritur prej jush. Mendoj që për momentin mjafton kaq.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. E kuptojmë plotësisht. Megjithatë, në një pikë të caktuar duam që ZPS-ja të na shpjegojë se për çfarë arsye se ku do të dalë që kush i solli një person specifik aty. Sepse kjo është pjesë e pretendimeve dhe është shumë e rëndësishme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kjo pyetja nuk duhej të ishte ngritur tani, sepse po na çorienton. Sepse ZPS-ja po pyeste për diçka tërësisht tjetër. E kuptoj që keni shqetësimet tuaja dhe sigurisht që do të merreni të gjithë kohën e nevojshme. Megjithatë, duhet të zgjidhni me kujdes momentin kur ndërhyni.

Znj. Prokurore, ju lutem, vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Në versionin në anglishte është në faqen 29, rreshti 18 deri në 21.

PY. Z. Dëshmitar, në intervistën me ZPS-në në vitin 2019, ju bëhet kjo pyetje:

"A sillte njeri njerëz që të merreshin në pyetje, ndërkohë që ju punonit te porta ose për t'u hetuar ose për t'u marrë në pyetje?".

Përgjigja është:

"Nuk kam parë asgjë".

Ndërkohë që sot na thatë për marrjen në pyetje që realizohej me persona të cilat mbaheshin në ndërtesën nr. 1. A mund të na shpjegosh se pse nuk e ke përmendur këtë në intervistën që i ke dhënë ZPS-në në vitin 2019?

PË. Znj. Prokurore, po qëtu ka qenë përkthyesi i dobët. Nuk kam thënë se nuk ka, se kur je te porta roje patjetër njerëzit që ishin [e pakuptueshme] e çelsha derën e mshelsha derën. Po atë nuk kam pa asgjë, atë nuk kam thënë. Përkthimi është i dobët. Njerëzit vishin, hyshin, dilshin

PY. A ka pas ndonjë arsye se pse në vitin 2019 nuk keni përmendur që janë marrë në pyetje njerëz për shkak se ishin të dyshuar për gjëra të caktuara, ndërkohë që mbaheshin në shtabin e logjistikës në Kukës, z. Dëshmitar.

PË. I kam përmend, por përkthimi është kon; i dobët, se i kam përmend.

PY. A e kuptoj drejt që ju keni thënë që janë marrë në pyetje gjind për dyshime të caktuara në Kukës, por nuk e ka përkthyer përkthyesi, këtë po thua?

PË. Po.

PY. Tani dua që të kalojmë te përdorimi i shtabit të logjistikës në Kukës.

D.m.th. për çfarë përdorej shtabi i logjistikës në Kukës. E përmendët më herët dhe i referohem këtu faqes 15 të

transkriptit të përkohshëm që thatë që ishte është shtab i logjistikës dhe që përdorej për mobilizim. Këtë e thatë në faqen 18, rreshti 5.

A mund të na thoni diçka më tepër lidhur me qëllimet që pse përdorej shtabi i logjistikës në Kukës nga UÇK-ja? Pse e përdorte UÇK-ja shtabin e logjistikës në Kukës?

PË. Por e përdorte sebepi i ushtrisë se kishim mobilizime u bojke aty. U duhen në mëngjes me u çue, fizkulturë, që si të ushtrive që si gjona të ushtrive, për këtë send është kon shtabi i logjistikës.

PY. Çfarë do të thuash me "detyra ushtarake"?

PË. Po du të them që mobilizimi është bo. Qatu hajshim, pijshim, mëngjes u dujte fizkulturë, u duhet na me shku me marrë uniforma. Naj herë si rrallë uniforma në Shqipni për uniformat e UÇK-së. Me mbajt bukën [e pakuptueshme]me kamion.

PY. Lidhur me atë çfarë na thatë që ka të bëjë me ndërtesën 1, më përpara dhe njerëzit që mbaheshin të ndaluar aty për si të dyshuar. Të dyshuar si bashkëpunëtorë të Serbisë. A përdorej edhe për këtë qëllim? Se ti the përdorej për të verifikuar.

PË. Tash i përdora unë çka thashë për njerëzit e dyshimtë. Këta janë veç, këta janë civil nuk janë me uniformë. A na çka jemi konë me uniforma na jemi konë veç. Këta vec i merrshnin në pyetje që i dyshojshin, i përzishin prej shtabit aty. Si nuk dyshojshin i mobilizojshin në Ushtrinë Çlirimtare.

PY. A e dini se kush njësit i UÇK-së ishte i stacionuar aty në shtab, qëndronte në shtab të logjistikës?
PË. S'e kuptova pyetjen.
PY. A e dini se cili njësit i UÇK-së qëndronte në shtabin e logjistikës në Kukës?
PË. Jo, s'ka pas njësit. Atëherë në atë kohë s'ka pas njësit, që e keni fjalën për brigada.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund të shfaqim, a mund ta heqim deklaratën e Dëshmitarit në ekran?
ZNJ. WYLER: [Përkthim]
PY. Çfarë do të thuash kur thua në qoftë se i referohemi brigadave?
PË. Po s'ka pas atëherë njësit. Me si e kry lufta u formun brigadat.
PY. A ka pasur ndonjëherë ndonjë brigadë që qëndronte në shtabin e logjistikës në Kukës? Të stacionum atje ka pas ndonjëherë ndonjë brigadë?
PË. Ndoshta ka pa, kam harru.
PY. Sa ushtarë kishte atje, sa ushtarë kanë qëndruar në shtabin e logjistikës në Kukës?
PË. Po përditë vishin u mobilizojshin.
PY. A mund të na japësh një numër të përafërt se sa vetë ishin aty?
PË. Për tash, përditë vishin nga dy a tre. Tash ata dikur, 30

jemi konë në sobë që flejshim.

PY. Përderisa po flasim për shtabin e logjistikës, a kishte ndonjë ambient tjetër të UÇK-së në Kukës, a kishte ndonjë vend tjetër ku qëndronte UÇK-ja në Kukës përveç këtij vendi?

PË. Po.

PY. Ku ishte ky vendi tjetër, në çfarë vendesh të tjera qëndronte UÇK-ja?

PË. Aj tash me thënë përmas ndërtesës së shtabit të logjistikës nja 20 m më larg ka qëndru edhe një shtab nr. 1 u thirrke.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, thuajse ka ardhur koha e drekës.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] A mund t'i përdor edhe dy minutat e fundit?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. A e di për çfarë përdorej shtabi 1?

PË. Po atë shtab, me t'nime e kom, atë shtab e ka përdor Ruzhdi Saramati edhe ai ka bo mobilizim ka bo.

PY. Faleminderit.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Tani është moment i përshtatshëm për të bërë pushimin e drekës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë faleminderit. Faleminderit znj. Prokurore.

Z. Dëshmitar, do të bëjmë një pushim për 1.5 orë. Do të fillojmë përsëri në orën 2.30. Drekë të mbarë dhe do shihemi në orën 2.30 përsëri.

Seanca mbyllet këtu.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

--- Pauza e drekës fillon në orën 13.00

--- Seanca rifillon në orën 14.30

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se keni ardhur përsëri.

Me sa shoh ka ndryshuar përbërja e Prokurorisë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po. Z. Alex Whiting, është larguar për këtë seancë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E mora shënim.

Të tjerët janë të njëjtët.

Edhe ekipi i Mbrojtjes ka të njëjtën përbërje. Faleminderit.

Shumë mirë. Z. Shala është po ashtu aty.

Dhe tani do të kërkojmë të sillet dëshmitari.

Ju lutem silleni dëshmitarin, znj. Sekretare. Faleminderit.

Znj. Prokurore, pasi të keni përfunduar pyetjet do t'ia jap fjalën Sekretarit së Gjykatës të japi numrat ERN të dokumenteve që mund të keni përdorur gjatë pyetjeve.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Sigurisht.

[Dëshmitar vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, mirë se keni ardhë përsëri. Më dëgjoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po. Faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. Shala, e dëgjuat dëshmitarin?

Shoh që po tundni kokën. Është mirë që ta thoni me fjalë më mirë se duhet për procesverbal. Edhe pse stenografia nuk e sheh lëvizjen tuaj të kokës.

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni me pyetjet e dëshmitarit. Keni fjalën.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

Ju detyrohem disa referenca, në fakt, për përkthimet në shqip të materialeve që kemi përmendur me ato inicialet në skicë. Nëse doni mund t'jua jap tani.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, jepini.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Janë prova materiale me numër ERN 083537-TR-AT, Pjesa 1. Një tjetër është në faqen 27, rreshtat 11 deri në 20 dhe tjetra në faqen 28, rreshtat 9 deri 13.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Faleminderit. Pyetja që kam është, nëse kërkoni sqarime, duhet që me një fjalë kyç të tregoni se përse kërkohet sqarimi, për të shmangur pyetje të tjera, më duket se kur kërkonit sqarim për pikën A del një pikë tjetër. Kini kujdes pra.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Meqenëse pyetja tjetër ka të bëjë me një dëshmitar të mbrojtur, ju lutem të kalojmë në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem të kalojmë në seancë private.

[Seancë private]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë private teksti i fshirë]

[Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F579*

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Po e përsëris pyetjen, z. Dëshmitar.

Më përpara sot the se ata që mbaheshin në ndërtesën numër 1, i mbanin zakonisht për dy-tre orë. Në rastin e *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* që u mbajtën po ashtu në ndërtesën 1, the se i mbajtën për një kohë më të gjatë. Është e saktë kjo?

PË. E saktë është.

PY. Kishte edhe njerëz të tjetër që ti i njeh që janë mbajtur aty më shumë se dy-tre orë në këtë ndërtesën numër 1?

PË. Ka qenë edhe një rom ka qenë.

PY. Mos rastësisht e mban mend sesa kohë është mbajtur ky person në ndërtesën numër 1?
PË. Unë sa kam qenë për nja tri ditë katër. Edhe unë kam hec për Kalimash.
PY. Çfarë ke parasysh tre-katër?
PË. Tre-katër ditë kam qenë edhe unë kam ec për Kalimash me ushtarët.
PY. Po ky personi, ky roma që e mbajtën më gjatë në këtë ndërtesën 1, e mban mend për sa kohë e mbajtën aty atë person në këtë ndërtesën?
PË. Jo, s'e mbaj mend sa kohë ka qenë aty po unë -- e hupe atë *[REDAKTUAR]*
PY. Faleminderit.

Sot na the gjithashtu se në këtë ndërtesën 1 njerëzit i merrnin në pyetje dhe e ke thënë në transkriptin në faqen 32, rreshtat 16, 17. Gjithashtu na thatë kur ju pyetëm se pyetjet nuk bëheshin në ndërtesë tjetër me sa të kujtohet. Dhe kjo është në faqen 47, rreshtat 12, 14 të transkriptit.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Për këtë dua që t'ia freskoj kujtesën Dëshmitarit duke i paraqitur deklaratën që ka dhënë për Prokurorinë në 2022.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Pra, ju lutem paraqiteni në ekran provën materiale me numër ERN 083537-TR-ET, Pjesa 1 RED, faqja

11, rreshti 25 në anglisht.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Sekretar, të lutem paraqite këtë dokument.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, të kanë pyetur për "këtë ndërtesën që e ke shënuar me numrin 1 në skicën. Atë që e ke quajtur si puntori?"

Ti ke thënë:

"Numri 1 ishte si një lloj burgu".

Pastaj vazhdon në faqen tjetër, në faqen 12 dhe thua:

"Ishte në atë kohë si një lloj burgu. Aty i ndalonin njerëzit".

Dua që të paraqisni faqen 16 të të njëjtës provë materiale, rreshtat 11 deri në 12. Në rreshtin 11 thua:

"Pra, ata i merrnin në pyetje njerëzit që ishin në pozita më të larta" dhe i përmend si të ndaluar dhe ata i kanë pyetur në ndërtesën me numër 4 që e ke shënu ke ajo skica.

A e mban mend sot që njerëzit merreshin në pyetje në ndërtesën numër 4 dhe jo vetëm në ndërtesën numër 1?

PË. Znj. Prokurore, apet, po i ngatërroni sendet, 1998 me 1999. Unë kjartë e kam thënë edhe apet e them. Prej marsit dhe aprillit unë kam ndejt ndejti ka septemberi, a gushti kam ndejtë në shtab të logjistikës. Prej septembarit ka pasë njerëz që kanë ardhë që i kanë marrë në pyetje. Prej septembarit e ndej janarit unë kam qenë, septembar, oktombar,

tash një muaj poshtë e naltë, unë kam qenë në Kalimash në stërvitje. Janar, februar u kthye apet në Kukës unë. Apet ka pasë që i mirrshin në pyetje dhoma numër 1, i mirrshin në pyetje numër 4.

Aty kam qenë ndejti me thënë në mbarim të pestit muj, në mbarim të pestit muj. Demek të gjashtit muj tri ditë a katër qështu. *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]* Edhe unë s'ka zgatë shumë tri-katër ditë edhe kam hec unë për Kalimash. Me s'di sa ushtarë kam hec në Kalimash. Edhe kam shku në vijë të frontit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Z. Dëshmitar, dua t'i përgjigjesh pyetjes sepse e humba një çik fillin, u ngatërrove. Dhe duhet të kuptoj këto që po thoni.

Po ju bëj një pyetje. Z. Dëshmitar, në maj, pra, në muajin e pestë dhe të gjashtin qershor të vitit 1999, ku merreshin në pyetje njerëzit? Në cilën ndërtesë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Në pyetje u pyetshin në ndërtesën numër 4.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila ishte ndërtesa numër 4?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Qaty ku flijshim na.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ndërtesa numër 1, kur është përdorur kjo ndërtesë për pyetje, sipas mendimit tënd?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po si mbas mendimit

tem, kjo a përdorë prej 1998.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Që nga ç'kohë deri në ç'kohë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po prej 1998 nejti ku kam qenë nejti të gjashtin muj të 1999. Mandejna s'di kurrgjë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nga 1998 po thua deri në muajin e gjashtë të 1999 - ndërtesa 1 --

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] -- gjithashtu është përdorur si vend ku merreshin në pyetje njerëzit, kështu?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Aty, ajo ndërtesa numër 1, edhe njëherë znj. Gjyqtare, ka qenë sikur një lloj burgi me thënë, po s'ka qenë burg, po një lloj burgi. Prej aty i merrshin i bijshin pacientët në pavilionin numër 4 që i mirrshin në pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] "Pacientët" po thu?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po q'ata që i kanë si të dyshum.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit për sqarimin që na dhe.

Znj. Prokurore, vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, njerëzit që keni parë të mbaheshin të

ndaluar në këtë ndërtesën si burg, a e dini nëse këta njerëz janë keqtrajtu, janë maltratu gjatë kohës që janë mbajtur në këtë ndërtesë?

PË. Sa kam qenë unë jo, më anejna s'di.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] A mundet që të shfaqet në ekran prova materiale, një deklaratë e mëparshme e dëshmitarit që duket paksa e ndryshme për ta sqaruar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po. për këtë pikë konkrete, po. Mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Pra, dëshiroj që të paraqisni në ekran provën materiale 108836-TR-ET, Pjesa 1, faqja 17. Ndërsa në shqip është në faqen 20.

E kam fjalën për rreshtat 15 dhe deri në 18 në anglisht dhe për rreshtat 9, 11 në shqip.

PY. Ku thua:

"Të them të vërtetën nuk pashë njeri, por më duket se i kanë keqtrajtu".

Z. Dëshmitar, kjo është një deklaratë që i ke dhënë Zyrës së Prokurorisë në intervistën që të kanë bërë më 2022. Ju lutem, a mund ta sqaroni nëse keni dëgjuar ndonjë gjë apo keni parë gjë që ka të bëjë me keqtrajtimet e tyre në Kukës?

PË. Znj. Prokurore, apet a përkthimi i dobët.

Qe qysh është, unë as kam pa, as kam dëgju. Një Zot e din aty a i kanë torturu a jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

Mbrojtësi, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Ne e kundërshtojmë këtë mënyrë procedimi. Nuk ka pasë ndonjë mospërputhje. Në qoftë se qëllimi ishte që të dëgjohet se çfarë mendon dëshmitari e kundërshtojmë. Por ai tha se nuk ka parë gjë.

Mund t'i bëjnë pyetje nëse dëgjoi apo pa. Por ato që ata i kanë pyetur se çfarë mendon. Nuk jemi këtu për të dëgjuar mendimet, opinionet e dëshmitarit.

Për këtë kundërshtojmë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat i Mbrojtjes, nuk shoh ndonjë problem me këtë mënyrë të pyeturi për këtë çështje konkrete. Në qoftë se Prokurorja nuk do ta kishte bërë këtë pyetje do ta kisha bërë unë pyetjen në një moment tjetër për të kuptuar se nga ka dalë kjo.

Pra, mund të vazhdojmë.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

Po e lë këtë temë dhe po vazhdoj te struktura komanduese e UÇK-së në shtabin logjistik në Kukës.

PY. Z. Dëshmitar, për sa i takon hierarkisë, strukturës së UÇK-së në bazën logjistike në Kukës, mund të na thuash si ishte organizuar? Kush ishte komandanti aty?

PË. E keni fjalën për -- znj. Prokurore, s'e kuptova pyetjen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Prokurore, nuk është bërë kjo pyetje sot, se dëshmitari përmendi tre komandantë?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Ai përmendi tre komandantë për gjëra të tjera, lidhur me zyrat me pyetjet por nuk foli për strukturën komanduese.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Dëshmitar, çfarë mund të na thuash për strukturën organizative të UÇK-së në Kukës? Si ishin organizuar, si qe organizuar UÇK-ja?

PË. Po organizimin e kanë bë këta komandantët e mëdhenj organizimin e UÇK-së e kanë bë.

PY. Mund të na thoni se cilët ishin komandantët përgjegjës në shtabin logjistik në Kukës?

PË. Po ka qenë Sali Saramati, ka qenë Xhemshit Krasniqi. Qëta kanë qenë, a po më merr vesh. Kanë, po tash këta kanë qenë veç aty për Kukësin. Aty kanë ardhë edhe komandantët më të mëdhenj pak ça janë Hashim Thaçi, Fatmir Limaj, Azem Syla.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duhet të vazhdojmë të jemi në seancë private.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo. Ju kërkoj ndjesë. Mund të dalim nga seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Sekretar, të kalojmë në seancë publike, ju lutem.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike. Faleminderit.

Znj. Prokurore, mund të vazhdoni.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Dëshmitar, sapo përmendët që komandantët përgjegjës në Kukës, në shtabin në Kukës, ndër të tjerë ishe Sali Saramati, Xhemshit Krasniqi. Patë aty edhe Azem Sylën dhe Fatmir Limaj. Po Sabit Gecin e ke parë ndonjëherë aty?

PË. Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një minutë, Dëshmitar. Prit.

Mbrojtësi.

Z. AOUINI: [Përkthim] Nuk u përmend z. Hoxha, Hafir Hoxha.

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Po e përmendi më herët si komandant.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E ka përmendur në një fazë të mëparshme.

Z. AOUINI: [Përkthim] Por më duket se ishte në një kontekst tjetër. Pyetja ju bë kush ishte përgjegjës dhe ne po e lëmë po --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk dua ta lë. Nuk i lëmë gjërat në mes të rrugës. Pyetja që bëra më parë kishte të bënte me, në qoftë se nuk e përsëriste pyetjen, se mu duk se ishte pjesërisht pyetje që ishte bërë më

përpara, sepse më përpara u përmendën tre komandantët. Prandaj e lejove emrin e tretë, sepse ishe përmendur më herët dhe kështu e kuptova. Po më korrigjoni po ta kem gabim?

Por, meqë dua që të dali çdo gjë sa më qartë që të jetë e mundur, mund të pyesim për emrin konkret përsëri, pra, për veçori të mëtejshme lidhur me këtë emër konkret.

E zgjidhim kështu shqetësimin tuaj?

Z. AOUINI: [Përkthim] Po. Si përgjigje për pyetjen e fundit. Ishin dy apo tre emra.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]

PY. Z. Dëshmitar, më herët përmendët se në bazën logjistike në Kukës ishte i pranishëm Hafir Hoxha. A ishte dhe ai një nga komandantët aty?

PË. Ai ka qenë, që t'i ndajmë znj. Prokurore, t'i ndajmë strukturat, Hafir Hoxha ka qenë komandant i policies ushtarake i FARKU-t. Sabit Geci ka qenë komandant i policies i Hashim Thaçit.

PY. Ndonjëri prej tyre ose të dy, domethënë, Hafir Hoxha dhe Sabit Geci, a kanë qenë të pranishëm në shtabin e logjistikës në Kukës vetë?

PË. Po.

PY. A e ke parë vetë Sabit Gecin të ketë qenë i pranishëm në muajin e pestë dhe të gjashtë të vitit 1999 në shtabin e logjistikës në Kukës?

PË. Po. E kam pa se ka ardhë prej spitalit të Ljubjanës, se

ka qenë i plagosun me shtaga ka ardhë, a kanë vetëdije.
PY. Z. Dëshmitar, a njihni një ushtar të UÇK-së që e ka emrin Bedri që ka qenë i pranishëm në shtabin e logjistikës në Kukës gjatë kohës që ke qenë edhe ti aty?
PË. S'e kuptoj. Edhe njëherë pyetjen?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A mund ta heqim transkriptit, apo ju duhet akoma?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo. Prova materiale nuk na duhet më. Mund ta heqim.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

ZNJ. WYLER: [Përkthim]
PY. Kur ke qenë ti aty në shtabin e logjistikës në Kukës, a ke takuar me një ushtar të UÇK-së me emrin Bedri?
PË. Po. Bedri Dervishaj.
PY. A mund të na thoni se çfarë detyre kishte Bedri Berisha [sipas përkthimit] në shtabin e logjistikës në Kukës?
PË. Ai a kanë ushtar i Ruzhdi Saramatit në pavilionin numër 1, po vike aty te mjeku, te mjeku me u kontrollue.
PY. Faleminderit. Kam dy apo tri pyetje të tjera që më kanë ngelur për t'i bërë dëshmitarit.

I drejtohem transkriptit provizor në faqen 58, rreshti 12, ku na thatë që ikët, u larguat nga shtabi logjistik i Kukësit duke filluar nga muaji i gjashtë i 1999 dhe ikët për në Kalimash.

Pyetja ime është kjo: Për sa kohë ke qëndruar në Kalimash?
PË. Në Kalimash kam qëndru pak ditë, ja dy javë a tri javë dhe kam shku mbasandajna në vijë të frontit.
PY. Pas këtyre dy-tre javëve nga aty ku shkuat pastaj?
PË. Shkumë në Pogaj, në vijë të frontit.
PY. Dhe për sa kohë qëndruat në Pogaj në vijë të frontit?
PË. Po në Pogaj kemi qëndru ja një javë ditë kemi qëndru.
PY. Po nga aty ku shkove pastaj?
PË. Prej aty, znj. Prokurore, nisi u bë marrëveshja e Kumanovës, kemi nejt tani dhe ja një javë ditë në Pogaj edhe kemi shku për Nashefc.
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
PY. Faleminderit.
ZNJ. WYLER: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këto ishin të gjitha pyetjet që kishim për këtë dëshmitar.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Prokurore.
Dëshiroj t'i kthehem një pike që ka të bëjë me Mbrojtjen. Kur po flisja për informacionin e ndarë ose dëshmitë e ndara nga, domethënë, dëshmi që na ka dhënë dëshmitari neve, bëhet fjalë për faqen 47, ku dëshmitari po fliste për këta më "të mëdhenjtë" e "komandantët". "Të cilët po kujdeseshin për

verifikimin e këtij informacioni", domethënë kjo është referenca në transkript. Se po fliste për verifikimin.

Dhe tha që:

"Komandantët që ishin në Kukës ishin përgjegjës për verifikimin".

Ju bë pyetja:

"A mbani mend emrat?"

Dhe ai vazhdoi dhe dha përgjigjet. Përmendi tre emra, një nga të cilët ishte edhe emri i Hafir Hoxhës. Për t'ju thënë se cili ishte burimi i asaj që sapo thashë.

Domethënë, për referencë është faqja 47, rreshtat 4 deri në rreshtin 10.

Znj. Prokurore, faleminderit.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ka mbetur një çështje tjetër për t'u sqaruar që janë numrat ERN për provat materiale të përdorura nga Prokuroria.

Z. Sekretar, ju lutem e keni fjalën ju.

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.

Dokumenti i dytë ku ka bërë shënime Dëshmitari 10 është dokumenti me numër identifikimi ERN 065597 që është një fragment nga një dokument më i gjatë me numër identifikimi ERN nga 065597 deri në 065612 dhe ka marrë numrin e identifikimit

si provë materiale ERN REG00948.

Dokumenti tjetër ku u bënë shënime nga Dëshmitari 10 që ishte dokumenti fillimisht me numër identifikimi 065600, që është marrë nga dokumenti më i gjatë me numër identifikimi 065597 deri në 065612, ka marrë numrin e provës materiale ERN REG00949.

Ndërkohë dokumenti i fundit ku ka bërë shënimet Dëshmitari 10 që është dokumenti fillimisht i identifikuar si 074390, nga dokumenti që fillon me 074390 deri në 074391, tani merr numrin e provës materiale ERN REG00950.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Sekretar.

Kemi përfunduar me marrjen në pyetje të Dëshmitari 10 nga Zyra e Prokurorit të Specializuar. Tani do t'i jap fjalën Mbrojtjes së Viktimave për të bërë pyetjet e tij.

Mbrojtja e Viktimave, e keni fjalën.

Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit. Kam shumë pak pyetje për t'i bërë dëshmitarit.

Pyetje nga Mbrojtësi i Viktimave: [Përkthim]

PY. Mirëdita, z. Dëshmitar. Unë në këtë çështje jam Mbrojtje për Viktimat, do t'ju bëj shumë pak pyetje. A më kuptoni?
PË. Po.
PY. Si ushtar në UÇK, a merrnit urdhra nga komandantët, a ju jepnin komandantët urdhra si ushtarë në UÇK?
PË. Po.

PY. Dhe ju priteshit që t'i respektonit këto urdhra, apo jo?

PË. Po.

PY. Dua t'ju pyes në qoftë se ka ndodhur kështu edhe me rastin e Pjetër Shalës. E kupton çfarë po të pyes?

PË. Po e kuptoj sha je tuj pyet, po me Pjetër Shalën unë s'kam kurrfarë lidhje.

PY. A ke pasur ndonjëherë mundësi që të krijosh një opinion mbi faktin në qoftë se ai vetë i respektonte urdhrat që merrte nga komandantët?

PË. Po tash ai hike, dilke kërrkund s'e vetke. Ike, dilke, kërrkund s'e pytke aty. Tash ai e din vetë.

PY. Po. Për momentin nuk e pyesim dot vetë atë, kështu që po të pyesim ty.

Z. LAWS: [Përkthim] E shoh që Avokati i Mbrojtjes është në këmbë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E keni fjalën ju, Avokat Mbrojtës.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Dhe ju kërkoj ndjesë që ju ndërpresim.

E kundërshtojmë fort nxjerrjen e fakteve ose të opinioneve nga dëshmitari.

Z. LAWS: [Përkthim] Nuk është -- nuk kemi opinionin e tij por thjesht po flasim për shumë subjekte të tjera. Domethënë, ne nuk mund t'i japim opinionet tona sa i takon çështjes së ekspertizës. Megjithatë në këtë fazë duhet t'i bëjmë atij

pyetje.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare që jeni e pranishme në vendin ku është dëshmitari, ju lutem a mund ta nxirrni nga dhoma dëshmitarin.

Z. Dëshmitar, do të nxjerrin nga dhoma ku jeni.

[Dëshmitari përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARJA E SEANCËS: [Përmes videolidhjes][Përkthim] Konfirmoj që dëshmitari dhe avokati i tij kanë dalë nga dhoma.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Sekretare.

Atëherë Mbrojtja e Viktimave është në këmbë dhe do t'jua jap përsëri fjalën juve Mbrojtjes së të akuzuarit.

Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar Gjykatëse.

Unë e mora gjysmën e përgjigjes që dëshiroja që të merrja nga dëshmitari dhe është marrë përgjigja në një mënyrë tërësisht legjitime. Për shembull, në transkriptin provizor në faqen 88, dëshmitari ka thënë, në rreshtin 12, sa i takon Pjetër Shalës që:

"Ai hynte dhe dilte pa kërkuar leje nga askush ...".

Këtë ka thënë dëshmitari, ky mund të jetë ose ndoshta nuk është një provë ose informacion i rëndësishëm për t'u shqyrtuar nga Trupi Gjykues. Megjithatë kjo është një temë për të cilën ai ka folur, ka folur gjatë intervistave të tij dhe mendoj që do ta ndihmoj Trupin Gjykues për të kuptuar çfarë

pozicioni ka pasur ai në Kukës.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Thatë që e keni marrë gjysmën e përgjigjes.

Z. LAWS: [Përkthim] Po.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Cila do ishte gjysma tjetër e pyetjes atëherë?

Z. LAWS: [Përkthim] Gjysma tjetër është që a e di dëshmitari se cila ishte arsyeja që z. Shala hynte e dilte pa leje dhe që kishte këtë lloj lirie. Informacion që cilin ai e ka dhënë në intervistën e vetë dhe faktin që ai ishte person që i kishte lidhjet e forta. Për shembull, që "Ishte një person i Ramushit, Ramush Haradinajt" Dhe në vetvete ky është një informacion i rëndësishëm, aspekt i rëndësishëm, që Trupi Gjykues duhet ata shqyrtojë në morinë e shumë provave të tjera në këtë çështje gjyqësore.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptoj plotësisht. Po thjesht jua kërkova në mënyrë që të dinim se ça do vijë më pas, në mënyrë të tillë që Mbrojtja tani që të bëjë, le të themi, një lloj parashikimi do bëjë. Domethënë, është më mirë që ta kemi këtë diskutim tani sesa ta bëjmë, domethënë, të kalojmë nga njëra palë te tjetra.

Z. LAWS: [Përkthim] Pra, faleminderit. Më lejoni të them që ligji në vetvete nuk kërkon opinionet tona. Për shembull, në qoftë se dal jashtë dhe po bie shi, unë mund të them, mund të them, për shembull, që është ftohtë jashtë. Po këto janë

opinione dhe nuk është e thënë që këto opinione të jenë të papranueshme nga Trupi Gjykues. Pra, në qoftë se unë them që dikush hynte dhe dilte, unë mund të krijoj një opinion lidhur me këtë person dhe mund ta raportoj këtë informacion dhe pastaj varet nga Trupi Gjykues në qoftë se këtë informacion do ta marrë parasysh apo jo.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Mbrojtës, e keni ju fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit, znj. Gjykatëse.

Ne nuk pajtohemi me Mbrojtjen. Pra, po flasim për marrëdhënien ndërmjet pyetjes dhe përgjigjes. Ne kundërshtojmë mënyrën sesi bëhet pyetja. Në parashtrimin tonë, ne themi që së pari, dëshmitarit duhet t’i bëhet pyetja në qoftë se e dinte dhe mbi çfarë bazë e kishte këtë informacion. Sepse dëshmitari është dëshmitar fakti. Ai nuk ka thënë në dëshminë e tij, nuk ka dhënë një informacion që mund të çonte në bërjen e pyetjes ose në formulimin: Në qoftë se ai mund të krijonte një opinion në qoftë se ai i respektonte rregullat apo jo.

Pra, së pari duhet që të bëjnë pyetjen që a ishte në dijeni të këtij informacionin, në qoftë se e dinte këtë informacion nga e kishte marrë vesh këtë informacion. Dhe pastaj bëhen pyetjet e tjera. Pra, dëshmitari duhet që të na tregojë se çfarë ka dëgjuar, çfarë di. Dhe kjo duhet të jetë baza mbi të cilën bëhet një pyetje tjetër që ka të bëjë me

opinioni e vetë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ndoshta përdorimi i fjalës "opinion" sjell një lloj paqartësie ose çon në këtë debat që po kemi tani. Megjithatë, mendoj që është pyetje legjitime, pra, për të bërë pyetjen që bëri Mbrojtja e Viktimave lidhur me z. Shala, pra, çfarë ka parë, çfarë ka vërejtur dëshmitari, sepse atë do të na thotë dëshmitari. Ndërkohë që sa i takon peshës që do i japim këtij deklarimi këtë do ta përcaktojmë pak më vonë.

Do ta lejoj këtë pyetje. Dhe do bëj, do lejoj dhe pyetjen që fillon me pse. Megjithëse duhej ta kisha thënë ndryshe, atëherë do t'ju jap mundësinë që të ndryshoni mendjen.

Pra, a ka ndonjë arsye që pse ju mendoni që ne nuk duhet ta lejojmë këtë pyetjen me pse?

Z. AOUINI: [Përkthim] Në qoftë se e konstatojmë së pari që ai e ka parë, e ka vërejtur këtë informacion, sigurisht që informacioni që ka marrë, pra, lidhet me pyetjen tuaj. Se pse e ka bërë, pse e ka marrë këtë informacion, pra, për aq kohë sa jepet baza, për aq kohë sa jepet informacioni dhe për aq kohë sa kjo vjen si rezultat i fakteve, besoj që kjo është më se e shpjegueshme.

Më duket sikur z. Shala do të thotë diçka vetë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [Mikrofoni çaktivizuar]

Z. AOUINI: [Përkthim] Po, po. Po e ngritëm shqetësimin

tonë. Bëhet fjalë për një dëshmitar fakti. Pra, duhet që të sigurojmë që ka informacion, ka burim, në qoftë se personi është në gjendje që të na e japë këtë burim, domethënë, të na thotë që nga e ka marrë këtë informacion, në qoftë se ka dëgjuar diçka të tillë dhe pastaj në qoftë se ai thotë, po, sigurisht që mund të vazhdohet, është legjitime që të bëhet pyetja pse.

E para është që ai të japi burimin e informacionit, pra, gjërat që i ka parë ose që i ka dëgjuar por pyetja u formulua në mënyrë të tillë që nuk është e pranueshme, sipas nesh.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dëshironi që të flisni me klientin tuaj?

Z. Shala, pashë që ngritët dorën. Çfarë dëshiron të thuash?

I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Ju faleminderit, znj. Gjyqtare. Unë kam nevojë vetëm për një konsultim të shkurt para se me fillu pyetjet avokatët e mi, me të konsultim të shkurt nga avokatët e mi, në qoftë se më lejohet.

Ju faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, z. Shala. Do ta marrim parasysh këtë kërkesë tuajën kur të vijë momenti, pra, kur të vazhdojmë me pjesën tjetër të seancës, pasi të përfundojmë me pyetjet nga Mbrojtja e Viktimave.

I dëgjova shqetësimet tuaja, Mbrojtje e të akuzuarit,

megjithatë mendoj që këto dy pyetje mund t'i bëhen dëshmitarit. Ndërkohë kur ta merrni ju në pyetje dëshmitarin ju lutem ndihuni të lirshëm që t'i sqaroni këto gjëra me dëshmitarin.

Mbrojtja e Viktimave, dëshiroj t'ju informoj që do kërkoj që të kthehet përsëri në dhomë dëshmitari dhe pastaj mund të vazhdoni me pyetjet tuaja.

Z. LAWS: [Përkthim] Në rregull.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj. Sekretare, a mund ta sillni në dhomë dëshmitarin?

[Dëshmitari vijon dëshminë përmes videolidhjes]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë se u ktheve, z. Dëshmitar. Do t'ia jap përsëri fjalën Mbrojtjes së Viktimave tani për të vazhduar me pyetjet e tij.

Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit, e nderuar znj. Gjykatëse.

PY. Z. Dëshmitar, përpara sesa të dilnit nga dhoma, ti dhe këtë përgjigje. Kjo është e regjistruar në faqen 88, rreshti 12. Thatë si më poshtë lidhur me Pjetër Shalën:

"Ai hynte dhe dilte pa kërkuar leje nga askush..."

A të kujtohet që e thatë këtë përpara pak minutash?

PË. Po, më kujtohet. Po unë s'di a ka pasë leje ai a s'ka pasë leje.

PY. Para shtatë-tetë minutash ti the që:

"Ai hynte dhe dilte dhe nuk kërkonte leje nga askush..."

A është e saktë apo e gabuar --

PË. Po, e kam thënë.

PY. -- kjo që përmenda tani?

PË. Jo, jo. E saktë a. Po s'di unë a ka pasë leje a s'ka pasë Pjetër Shala. Kjo pyetja është e saktë.

PY. A e di ti arsyen se pse ai hynte e dilte pa kërkuar leje nga askush?

PË. Po Pjetër Shala ka ardhë më herët sikur unë aty në shtab të logjistikës. E ka kanë ndoshta e ka fitu besimin s'i kanë kërku leje. Ndoshta e ka pasë edhe leje. Unë s'e di, s'e kam pa.

PY. Ka kaluar shumë kohë që prej asaj kohe. A mund të mendoheni për një çast edhe do t'jua bëj edhe njëherë pyetjen.

A e dini arsyen pse Pjetër Shala ishe në gjendje të hynte dhe të dilte pa pyet askënd?

PË. Apet po e përsëris. Pyetja është e saktë. Por a ka pasë leje a s'ka pasë leje Pjetër Shala, unë s'e di. A ka fitu besimin te ata komandantët e mëdhenj.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua të flas me dëshmitarin.

Z. Dëshmitar, në fillim kur po flisnim për z. Shala, ti the se:

"Ai hynte e dilte nga aty pa kërkuar leje nga askush..."

Unë këtë e kuptova që ti the që ai nuk i kërkonte leje askujt, nuk kërkonte leje nga askush.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, pyetja është e saktë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Pastaj the, përgjigja, ti thua, përgjigja është e saktë.

Dhe pastaj ti thua:

"...që nuk e di a kishte ndonjë leje..."

Domethënë, ty të bëhet pyetja, ty, a është përgjigja e saktë. Mua më duket sikur këtu ka një mospajtim. Më duket sikur bie ndesh me veten tënde. Domethënë, në fillim fare thua që nuk pyet askënd. Dhe pastaj thua që: Nuk e dija në qoftë se kishte leje apo nuk kishte leje.

Tani pyetja që kam për ty është: Cila është njëra apo tjetra?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Znj. Gjyqtare, unë për vete leje merrsha te komandanti jem. Edhe ai ndoshta e ka pasë ndonjë komandant. Unë s'di kën e ka pasë komandant ai. Por hyke, dilke. Secilli si unë që jam kanë roje që hyjsha, delja. Dy herë që jam kanë si ushtarët tjerë kapia dilke. Kurrgjë s'kallzojke. Tash unë punët e brendshme të komandantëve s'i di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kuptoj. Po për mua nuk është e qartë. Nuk është e qartë sepse fillove duke thënë që z. Shala nuk kërkonte leje. Sepse mund të kishte thënë që në fillim fare që: Z. Shala hynte e dilte dhe nuk e di në qoftë se kishte leje për ta bërë këtë gjë apo

jo.

Kështu që për mua --

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Znj. Gjyqtare --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më dëgjoni, ju lutem. Z. Dëshmitar, ju lutem prisni derisa të përfundoj unë.

Për mua, nuk është e qartë se çfarë donit të thonit. Sepse duket sikur bie ndesh me veten tënde, megjithatë nuk jam shumë e sigurtë akoma. Thjesht po ju dëgjoj.

A e kuptoni ça po them? E kuptoni?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, po. Mirë e kuptoj. Po, po. Znj. Gjyqtare, Pjetër Shala s’ka flejtë në logjistikë aty. Pjetër Shala ka flejtë jashtë. Unë s’e di ku ka flejtë jashtë. A ka pasë ndoshta ndonjë shtëpi private a s’ka pasë. Unë s’e di.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk ka të bëjë fare kjo me pyetjen. Pra, së pari thatë që ikte e dilte pa leje dhe pastaj thatë që nuk e dinit. Thjesht po ju jap mundësinë që të na shpjegoni sesi qëndronte situata. Çfarë doje të thoje, të sqaroheni.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po apet po them që --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Një sekondë të përfundoj unë.

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] -- kërkon se vitke, kur vike --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë u kthyet prapë aty ku -- thatë përsëri atë çfarë thatë herën e parë.

Mbrojtja e Viktimave, ju jap fjalën dhe një herë. Mbase do të duhet që të shikohet deklarata e mëparshme që ka dhënë dëshmitari lidhur me këtë pikë.

Z. LAWS: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, e kam përpara. Në qoftë se do i kërkoja Sekretarit që të na e paraqesë në ekran është dokumenti me numër ERN 108836-TR-ET, pjesa 1, është faqja 21. Atëherë është dokumenti në faqen 24 në shqip. Ndërkohë që në versionin në anglisht janë rreshtat 8 deri në 11. Ndërkohë që në versionin tjetër janë rreshtat 7 deri në 12.

PY. *[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]* A e kupton?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E kupton Dëshmitar çfarë po bëjmë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Jo.

Z. LAWS: [Përkthim]

PY. T'jua shpjegoj dhe njëherë tjetër.
*[REDAKTUAR]*
*[REDAKTUAR]*
PË. Po.
PY. Transkripti i dëshmisë që ju i keni dhënë ZPS-së është shkruar, është përgatitur dhe pjesë e këtij transkripti është

paraqitur në të djathtë të ekranit që keni përpara. Ndërkohë që në majtë kemi versionin në anglisht.

Deri këtu më ndjek? Më kupton?

PË. Po.

PY. Ajo ça do të bëj unë tani është që do t'ju lexoj një pjesë të dëshmisë që i ke dhënë Prokurorisë që ka të bëjë me të njëjtën temë. Me temën që po diskutonim tani. A e kupton këtë?

PË. Po.

PY. Te rreshti 8, në anglisht dhe 7 në shqip. Po flitet për kohën që Pjetër Shala e mori *[REDAKTUAR]* nuk do të pyes për këtë. Po sa për ta gjetur ku është.

Z. AOUINI: [Përkthim] Jeni në seancë publike.

Z. LAWS: [Përkthim] Ju kërkoj shumë ndjesë. A mund të kalojmë në seancë private vetëm për një çast?

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private, ju lutem.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F579*

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Vazhdoni, Mbrojtësi i Viktimave. Do ta redaktojmë atë pjesë.

Z. LAWS: [Përkthim] Faleminderit.

PY. Ju thoni, a e shihni këtu:

"...ai ishte një person që nuk donte t'ia dinte për të tjerët, sepse ai kishte lidhje me njerëz lart".

A i shikoni këto fjalët që keni thënë? Thjesht më thoni "po" apo "jo" në fillim?

PË. Po.

PY. A ishte e vërtetë kjo që i thatë Prokurorit aso kohe?

PË. Po.

PY. Disa rreshta më poshtë nga kjo që sapo dhatë përgjigje, pesë rreshta më poshtë, është një pyetje që ju bëhet pikërisht për këtë temë. A e shikon, thotë:

"Ti the që Pjetër Shala kishte lidhje me të mëdhenjtë"

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Lexojani më mirë, se në vend që ta shikojë më mirë lexojani juve.

Z. LAWS: [Përkthim]

PY. Pesë rreshta më poshtë. Pyetja që ju bëhet është se:

"Ju thatë që Pjetër Shala kishte lidhje me të mëdhenjtë. Pra, ai ishte një person i rëndësishëm" thoni.

Ju thatë:

"...ishte njeriu i Ramushit.

"A mund ta konfirmoni se për kë Ramush e keni fjalën? Me emër të plotë dhe mbiemër".

PË. Ai ka qenë ushtar i Ramush Haradinajt.

PY. T'i kthehemi asaj ku filluam, a ishte kjo arsyeja pse ai vinte e shkonte si mbas qejfit nga objekti i logjistikës aty

në Kukës?

PË. S'e di.

PY. Sapo ju tregova përgjigjet që keni dhënë, ku ju thoni se kjo është arsyeja pse ai hynte e dilte si mbas qejfit. Pra, kjo do i --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua që së pari transkripti të ngrihet sepse nuk e shohim të gjithin.

Dhe e shoh që jeni ngritur Avokat i Mbrojtjes. Doni që të thoni që më mirë që dëshmitari të dali.

Atëhere vazhdoni.

Z. AOUINI: [Përkthim] Mbase dua t'ju ndihmoj. Një nga anëtarët e ekipit na ka thënë që shqipja, po të shikoni rreshtin 10 e më poshtë, nuk thotë saktësisht të njëjtën. Mbase është çështje përkthimi. Transkripti në shqip nuk është njëlloj, neve mund të ta dëgjojmë dhe njëherë përkthimin në anglisht mbasi të lexohet në shqip që të kuptojmë arsyen e mospërputhjes.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për cilin rresht e keni fjalën? Sepse nuk jam e sigurtë nëse mund ta bëjmë këtë gjë tani. Për cilat rreshta thoni që ka mospërputhje?

Z. AOUINI: [Përkthim] Në shqip. Faqja 24, rreshti 10 deri në 11.

Z. LAWS: [Përkthim] Nga rreshti 10 deri në 11 në anglisht

më duket se është. Nuk e di cila pjesë nuk është e saktë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'u kërkoj përkthyesve të përkthejnë rreshtat që më vini ju, po më thoni t'i përkthejnë nga shqipja në anglisht. Por për mua ka rëndësi se cilat janë këto rreshta, nuk dua që të bëj gjithë faqen, po dy rreshta nuk është problem. Na thoni cilat rreshta.

Z. AOUINI: [Përkthim] Për transkript, ekuivalenti i transkriptit në anglisht faqja 21, rreshtat 8, 11, ku u futëm në seancë private, në shqip është faqja 24 rreshtat 10 dhe 11 në gjuhën shqipe. Mbase këto dy rreshta mund të lexohen.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëhere e fillojmë te rreshti 9 që të dëgjojmë pyetjen në fillim. A mund, ju lutem përkthyesve, të përkthejnë në anglisht rreshtin 9 deri tek rreshti 12. Sepse është fjala e fundit te 12 i takon 11. Ju lutem.

[Përkthyesja përkthen në anglisht]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, znj. Përkthyese.

Avokati Mbrojtës, u zgjidh shqetësimi që ngritët?

Z. AOUINI: [Përkthim] Përkthimi ynë i thoshte që askush nuk u fut në punën e tij.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk po diskutoj me përkthyesit. Nuk po kundërshtoj që thonë përkthyesit në qoftë se doni verifikim kemi një procedurë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Thjesht po përpiqem të shpjegojmë se përse e ngritëm këtë çështje.

Z. LAWS: [Përkthim] Kuptimi është i njëjtë, me gjithë respektin e duhur, ajo që u bë thjesht u bë për të ndërprerë punën procedurat. Sepse, në fakt, ky përkthim është më emfatik.

Unë e thashë këtë vetëm për referencat e ardhshme.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por nëse ngrihen çështje përkthimi dhe mund të ndihmohen këto probleme, do përpiqemi t'i sqarojmë. Dhe në këtë rast e sqaruam.

Z. LAWS: [Përkthim] Komenti im nuk kishte të bënte me ju, por kishte të bënte me nevojën pse duhej që të harxhonim kohën, siç e harxhuam, duke parë një çështje përkthimi që, në fakt, s'kishte ndonjë çështje, ndonjë problem.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po e përsërit për shkak se askush nga ne - flasë për Trupin Gjykues - nuk flasim shqip, duhet të kontrollojmë. Dhe për këtë duhet kohë, por unë e quaj të domosdoshme.

Vazhdoni.

Z. LAWS: [Përkthim]

PY. Ka pak përpara, z. Dëshmitar, po ju pyesja, po ju bëja këtë pyetje apo një pyetje të ngjashme me këtë që po ju bëj.

Nga që Pjetër Shala kishte lidhje me të mëdhenjtë kishte mundësi të vinte e të hynte e të dilte si mbas qejfit nga

Kukësi, kështu?
PË. Po.
PY. Faleminderit.
Z. LAWS: [Përkthim] Nuk kam pyetje të tjera.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit, Mbrojtësi i Viktimave.
Po e përfundoj këtë.
Sekretar, ju lutem të kalojmë në seancë publike.
~~[Seancë e hapur]~~
SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.
KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.
Ora është 15 në katër, po e ndërpresim sot seancën. Do t'jua jap fjalën. Pra, do ta përfundojmë pas pak sot punën pa filluar pyetjet e palës suaj Mbrojtëse. Me qëllim që t'ju lejojmë juve, ekipin e Mbrojtjes, të takoheni me klientin dhe pastaj mund të rifillojmë nesër.
Avokati i Mbrojtjes, pashë që kërkuat leje për të folur.
Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit. Ju kërkoj ndjesë nëse u bëra shkasë për ndërprerjen e seancës. Nuk ishte absolutisht ky qëllimi im, ne përpiqemi që thjesht të sqarojmë gjëra.
Kemi një kërkesë që e bëmë pak më herët - mbase duhet ta trajtoni në seancë private, por mund të përpiqem ta bëjë dhe në seancë publike – ka të bëjë me një njoftim me disa pika që janë shumë të rëndësishme për Mbrojtjen për përgatitjen e vetë

për pyetjet që do t'i bëjë këtij dëshmitari, por ajo që ka më rëndësi, për dëshmitarët që do të vijnë në të ardhmen.

[Trupi Gjykues dhe Sekretari i Gjykatës këshillohen]

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Avokat i Mbrojtjes, së pari ta përfundojmë këtë pjesë të seancës dhe pastaj të vazhdojmë me çështjen tuaj.

Z. Dëshmitar, për sot, mbaruam me pyetjet tuaja. Nesër do të vazhdojmë dhe nesër do t'ju bëj pyetje Mbrojtja. Kështu që nesër do të takohemi përsëri në orën 09.30.

Dua t'ju falënderoj për kohën që ishit me ne këtu. Dhe dua t'ju kujtoj që deri nesër në mëngjes, nuk duhet të diskutoni dëshminë tuaj me askënd.

E kuptuat këtë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po, znj. Gjyqtare.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do t'ju ndihmojnë tani ata personeli që është aty. Përpiquni të pushoni dhe do të shihemi përsëri nesër mëngjes. E keni të qartë?

DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] Po. Ditën e mirë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Kalofsh një pasdite të mirë.

[Dëshmitar përfundon dëshminë përmes videolidhjes]

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Këtu do ta ndërpresim

videolidhjen me dëshmitarin.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Faleminderit edhe punonjësve të Gjykatës në anën tjetër. Kalojani mirënjohjen. Faleminderit.

Shumë mirë. Atëherë sot do të diskutojmë ndonjë çështje të mbetur pezull.

Mbrojtës, ju filluat me disa çështje që deshët t'i diskutonit me ne. Nuk e di se çfarë donit të diskutoni, nëse keni nevojë të futemi në seancë private.

Z. AOUINI: [Përkthim] Përdor disa fjalë kyçe dhe pastaj vendosim bashkë. Është fjala për disa akuza që janë në aktakuzë për dy pika konkrete. Njëra ka të bëjë me persona të mbrojtur --

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Duket sikur është duhet ta bëjmë në seancë private. Pika e dytë?

Z. AOUINI: [Përkthim] Është akuza e dytë për një bashkëkonspirator që pretendohet. Pra, dy pika për t'u sqaruar lidhur me çështje që do të paraqitet prej Prokurorisë. Njëra mund të trajtohet në publik. Por tjetra absolutisht ka nevojë të trajtohet në seancë private.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Të kalojmë në seancë private së pari.

Ju lutem, të kalojmë në seancë private.

~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur] *Riklasifikuar në bazë të F579*

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë private, të nderuar.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit.

Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

Z. AOUINI: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar Gjykatëse.

Sot dëgjuam mbase për herë të parë disa aspekte provash që kanë të bëjnë me dy pika. E para është transporti i viktimave të pretenduar në fabrikën e metalit në Kukës. Ka akuza në dosjen paraprake, mund t'ju jap referencat, që aty transferoheshin të ndaluar që ka të bëjë me akuzat e ngritura kundër z. Shala. Duhet të kemi njoftim të qartë të padiskutueshëm për prova që do të paraqiten nga Prokuroria

*[REDAKTUAR]*

Nëse nuk jemi të qartë mjaftueshëm do të ngremë rezervat tona, ne duhet të dimë se cili është qëndrimi i ZPS-së nëse z. Shala

*[REDAKTUAR]*

sepse kemi dy versione të ndryshme nga ky dëshmitar *[REDAKTUAR]* dhe ne kemi nevojë që të përgatitemi për Mbrojtjen duke e ditur qëndrimin e ZPS-së. Ndryshe ZPS-ja në mënyrë të palejueshme do të lejohet ta ndryshojë çështjen me ecurinë e provave materiale. Kjo ishte e dëshmisë.

Nuk po them gjë konkrete, por duhet të sqarohemi lidhur me këtë provë, me këtë akuzë konkrete. Duhet ta dimë nëse do

t'i përgjigjemi apo jo kësaj akuze, bazuar në këtë që do të thotë dëshmitari dhe mbasi të dëgjojmë sqarimin e Prokurorisë. Është ai, sipas Prokurorisë, apo është dikush tjetër, *[REDAKTUAR]*

Kjo është pika e parë dhe mund ta lë me kaq.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo, propozoj që t'i ngrini të dy çështjet.

Z. AOUINI: [Përkthim] Pika e dytë është që duhet të kemi indikacione të qarta nga ZPS-ja lidhur me Bedriun. Bedriu është emri i një bashkëkonspiratori. Ne dëgjuam pyetjen e kolegut të nderuar. Pyetja u bë si Bedri. Bedri është emri. Ne kemi bërë hetimet tona, kemi parë prova e nxjerra nga ZPS-ja dhe ka shumë Bedri që lidhen me UÇK-në, me brigadën, me fabrikën e metalit në Kukës. Kemi parë që disa hetime që ka bërë ZPS-ja.

Pra, në këtë fazë ZPS-ja duhet të na tregojë se për cilin Bedri bëhet fjalë. Bedri mund të jetë dhe një nofkë, po mund të jetë dhe emri i një personi. Dhe kjo do të na udhëheqë për përgatitjet tona, do të na ndihmojë, sepse e kemi hetuar dhe ne këtë pikë dhe ka shumë implikime provuese dhe ligjore.

Është Bedri Dervishaj që dëgjuam sot apo ndonjë tjetër. Të pakët dy Bedri i kemi dëgjuar, për dy Bedri kemi dëgjuar të flitej që jua ka paraqitur një nga dëshmitarët e mundur.

Duam, pra, të sqarohemi për këtë pikë përpara se të vazhdojmë me dëshmitarët e tjerë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Referencat janë të rëndësishme në këtë drejtim.

Z. AOUINI: [Përkthim] Unë i kam këtu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju lutem, përmendini për procesverbal, që ta kemi dhe ne në transkript.

Z. AOUINI: [Përkthim] Pra, në aktakuzën e korrigjuar, është F00098, paragrafi 10. Përmendet Bedri. Që ka nofkën Bedri.

Pastaj tjetri që ka të bëjë me transportin e të ndaluarve. Transporti i tyre në përgjithësi, ne kemi bërë parashtrime se qëndrimi i ZPS-së lidhur me një nga dëshmitarët që është i vdekur. Po ne duam të sqarohemi për këtë.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në qoftë se s'na e jepni tani, na e jepni nesër në mëngjes referencën, që ta përfundojmë.

Z. AOUINI: [Përkthim] E kam. E kam.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Z. AOUINI: [Përkthim] Është F00139, paragrafi 31, që ka marrë pjesë në transportin dhe transferimin e W04733, që është dëshmitari që nuk gjendet, që ka vdekur. Pra, duhet të sqarohemi nëse *[REDAKTUAR]*, si mbas akuzave të ZPS-së është person që është transferuar nga Pjetër Shala. Apo është dikush tjetër, *[REDAKTUAR]* apo ndonjë person tjetër.

Faleminderit.

Më falni. Është shtojca 1 e parashtrimit F00139.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në rregull.

Tani mund t'ia jap fjalën ZPS-së nëse janë në gjendje të përgjigjen, ndryshe, nëse jo, do të vazhdojmë nesër.

[Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

Z. DE MINICIS: [Përkthim] Shkurt. Është një çështje shumë e gjerë kjo që ngrihet nga Mbrojtja që e tejkalon fushëveprimin e pyetjeve të këtij dëshmitari.

Pra, ne do t'i lexojmë parashtrimet sot dhe nesër do t'u jap përgjigje.

Për sa i takon njoftimit, ne kemi dhënë njoftim të mjaftueshëm përmes aktakuzës dhe dosjes paraprake.

Për faktin që disa hollësi që do të dalin gjatë dëgjimit të dëshmisë mund të ndryshojnë nga akuzat fillestare, po kjo është detyra juaj si Trupi Gjykues. Nuk besoj se do ta vendosim Mbrojtjen në pozitë të vështirë lidhur me ushtrimin e të drejtës së tyre për të mbrojtur klientin e tyre në mënyrë të efektshme.

Mbrojtësi, kolegu Mbrojtës, bëri disa parashtrime lidhur me disa ndryshime të pretenduara lidhur me disa dëshmitarë që ne mendojmë se nuk duhet t'i diskutojmë tani. Sepse dëshmitari duhet që të dëgjohet njëherë. Ne do të shohim nëse mund të japim ndonjë sqarim, por në qëndrim është që çështja jonë

është mjaftueshëm e qartë dhe i është bërë e njohur Mbrojtjes dhe mund të vazhdojmë kështu.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në qoftë se keni ndonjë tjetër, Avokat i Mbrojtjes, mund ta ngrini.

Z. AOUINI: [Përkthim] Ne besojmë se janë fakte materiale të cilat duhen deklaruar. Mbase për këtë nevojitet një vendim.

Të dy pikat që u diskutuan sot, pra, është *[REDAKTUAR]* *[REDAKTUAR]*, pra, nuk
është përtej këtij dëshmitari, pra, lidhet me të dhe do të bëhet dhe më problematike në qoftë se ecim në një terren të paqartë. Ne duhet ta dimë se për çfarë duhet të japim përgjigje, mendojmë që janë çështje me rendësi materiale.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për momentin po i lëmë të pavendosura. ZPS-ja do të shoh nëse mund të bëj diçka, pastaj, nëse lind nevoja, ne si Trupi Gjykues do të mbajmë qëndrim.

Faleminderit.

Dhe t'i kthehemi dhe njëherë asaj që sapo thatë për faqen 103, rreshti 25, nuk na keni ndërprerë punën, nuk na kemi devijuar nga qëllimi në interesin e çështjes, palët dhe pjesëmarrësit ngrenë ato çështje që i mendojnë të rëndësishme, të nevojshme.

Z. AOUINI: [Përkthim] Doja të thosha që ua ndërpreva punën.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në këtë drejtim ka ndonjë gjë tjetër ju si Mbrojtës i Viktimave?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, faleminderit.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Atëhere po shikoj edhe njëherë, drejtohem nga Prokuroria.

Faleminderit, Sekretar.

Të kalojmë në seancë publike.

~~[Seancë e hapur]~~

SEKRETARI I SEANCËS: [Përkthim] Jemi në seancë publike.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faleminderit shumë, Sekretar.

Pra, ka gjë tjetër që doni ta ngrini ju të Prokurorisë?

ZNJ. WYLER: [Përkthim] Jo, nuk kemi.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë mirë.

Mbrojtësi i Viktimave?

Z. LAWS: [Përkthim] Jo, asgjë s’kemi dhe ne.

KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Do të rifillojmë nesër në orën 9.30. Falënderoj pjesëmarrësit, palët për pjesëmarrjen e tyre në seancën e sotme. Dhe të gjithë ata që na ndihmuar sigurinë, përkthyesit, stenografen dhe sigurisht Njësinë e Mbrojtjes dhe Mbështetjes së Viktimave.

Mbaron seanca sot.

--- Seanca mbyllet në orën 15.58